

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5839
E hënë, 29 korrik 2019
çmimi 0.40 €

Zgjedhjet e parakohshme do t'i kushtojnë Kosovës 4 deri në 5 milionë euro



FAQE 7

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

TRI LLOJET E SHTETIT SOCIAL

F. 8

Shkruan: Sabri
KIÇMARI



PËR NJË KONCEPT TË MIRËFILLTË URBANISTIK-ARKITEKTONIK PËR SHTATOREN E ADEM DEMAÇIT

F. 12

Nga: Arianit
BYTYÇI, arkitekt



FLET PËR "EPOKËN E RE", VALDRIN LLUKA | FAQE 4-5

AKR-ja nuk do ta ketë problem kalimin e pragut zgjedhor

- Duhet të shkojmë sa më shpejt në zgjedhje
- Pasojat do të jenë të mëdha nëse dështon projekti i termocentralit 'Kosova e Re'

Ministri në detyrë i Zhvillimit Ekonomik që vjen nga radhët e Aleancës Kosova e Re (AKR), Valdrin Lluka, ka thënë se vendimi për dorëheqje i kryeministrit ishte i papritur për të dhe AKR-në. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se sa më parë duhet të mbahen zgjedhjet e parakohshme që mos të mbesin të bllokuara projektet që e presin Kosovën. Lluka ka bërë me dije se

AKR-ja është e gatshme për zgjedhje të reja, duke theksuar se për këtë parti nuk do të jetë problem kalimi i pragut zgjedhor. Sa i përket bashkëpunimit me parti politike, anëtari i kryesisë së AKR-së ka pohuar se nuk kanë vija të kuqe si parti. Në këtë intervistë Lluka ka folur edhe për ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re", për gjendjen në Telekom dhe për ndërmarrjen "Trepça"



AKTUALE

NË BAJGORË U MBAJT 'DITA E MËRGATËS'

F. 6

GJENDJA E SIGURISË NË DEÇAN, E QETË

F. 6

EKONOMI

ARKA E SHTETIT PËR GJASHTË MUAJ GRUMBULLOI RRETH 900 MILIONË EURO

F. 9



SPORT

RAMADANI: SIVJET MEDALJA E ARTË, VITIN TJETËR KAMPION BALLKANIK

F. 20



Partitë, të hapura për koalicione



Pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj, subjektet politike, përveçse kanë shprehur gatishmërinë për zgjedhje, janë të hapura edhe për koalicione parazgjedhore. Liderët e partive politike të cilët kanë filluar mobilizimin e strukturave partiake për zgjedhje të reja nuk kanë hezituar t'i

përmendin edhe emrat e partive me të cilat dëshirojnë koalicione. Disa prej tyre kanë përmendur edhe vija të kuqe. Ndërsa presidenti Hashim Thaçi ka paralajmëruar se këtë javë do t'i fillojë konsultat me partitë politike për ta tejkaluar situatën pas dorëheqjes së kryeministrit të vendit | FAQE 3

Sejdiu: Jam i gatshëm ta marr përgjegjësinë e liderit të LDK-së

FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Malaj: Do të kthehem në PS, këta e molën dhe e shkatërruan

TIRANË, 28 KORRIK - Kur të tjerët do ta fillojnë ta braktisin sapo PS-ja të dalë në opozitë, vendosa të kthehem në PS, me integritetin e pacenuar, me profesionalizimin e thelluar dhe me dashurinë e shtuar. Nga mençuria dhe krenaria labe janë inspiruar përherë në vendimarrjet e mia, ka thënë ish-ministri Arben Malaj.

"Më 1991 ata që e molën Partinë e Punës e braktisën të

parët dhe u kthyen po të parët për t'i thithur deri në pikën e fundit, në pikën ku nga gjinjtë e nënave del më shumë gjak se qumësht. Nënave u shkon dhimbje në zemër dhe prapë durojnë. Më 1991 unë iu bashkova socialistëve vlonjatë për modernizimin e PS-së. Isha me shumë fat që bashkëpunova si nënkryetar i PS-së në Vlorë me qindra socialistë të ditur, fisnikë, trima dhe krenarë. Dy më të

spikaturit, Gëzimin dhe Nikon. Ulëm agresivitetin partiak në Vlorë, e hapëm partinë për të gjithë duke spikatur dhe promovuar më të mirët. E drejtuam PS-në në vitet e 'çmendura' të viteve më të vështira të tranzicionit. Në 2013-n kur vinte era dhe pushteti të dehte, dhe të babëziturit luftonin për pjesën e tyre të madhe në tepsinë e socialistëve, u vetëlargova nga PS-ja", ka thënë Malaj.



Rama: Kemi jetë të vështirë politike, por nga BE-ja s'heqim dorë

"BE-ja është e para dhe më e rëndësishmja për ne, prandaj nuk heqim dorë prej saj. Edhe pse Evropa nuk po shkon mirë, ne prapë e duam. Duhet të ndërtojmë një vend evropian me institucione, shtet të së drejtës, demokraci funksionale dhe është me rëndësi të kuptohet se ne jemi evropianë, por të qenit pjesë e BE-së për ne nuk është ta shtosh rrëmujën", ka thënë Rama



TIRANË, 28 KORRIK - Kryeministri Edi Rama u ka dërguar një mesazh të prerë vendeve të Bashkimit Evropian teksa ka deklaruar se nuk do të heqë dorë derisa Shqipëria të bëhet pjesë e familjes së madhe evropiane. "Bashkimi Evropian është i pari dhe më i rëndësishmi për ne, prandaj nuk heqim dorë prej saj. Edhe pse Evropa nuk po shkon mirë, ne prapë e duam. Duhet të ndërtojmë një vend evropian me institucione, shtet të së drejtës, demokraci funksionale. Është me rëndësi të kuptohet se ne jemi evropianë, por të qenit pjesë e BE-së për ne nuk është të shtosh rrëmujën", ka thënë kryeministri.

Kryeministri Rama ka folur edhe për fillimet e tij në politikë, nga Forumi Convoco, në

Salsburg. Ai ka deklaruar se nuk e kishte menduar kurrë të bëhej ministër dhe për herë të parë ka shkelur në godinën e Ministrisë së Kulturës, kur u bë ministër i Kulturës në vitin 1998. "Në vitin 1998 m'u dha puna e ministrit të Kulturës. S'kisha menduar kurrë të bëhesha ministër dhe Ministria e Kulturës ishte godina e parë ku kam hyrë. Kur u bëra kryetar bashkie gjeta një qytetar pa hapësira publike, njerëzit jetonin në hapësira shumë të vogla, ata ndërtonin bunkerë për t'u mbrojtur, në vend të shtëpive. E nisëm me llyerjen e ndërtesave. Ishte një operacion politik me ngjyra. Mendova se po gaboja, thashë se duhet të ndaloj, por bëra një anketë, ata që pëlqenin ishin 67 % dhe 85 % e njerëzve donin që

të vazhdoja", është shprehur kryeministri Rama.

"Më lejoni të them një gjë, Shqipëria ishte i vetmi vend në Evropë ku kishte më shumë hebrenj pas luftës sesa përpara luftës. I vetmi vend në Evropë ku asnjë hebre nuk iu dorëzua nazistëve. Ajo që i çudit nazistët është që familje myslimane mbrojtën hebrenjtë dhe Kardinali Katolik shqiptar realizoi shumë kungime false për t'iu dhënë hebrenjve një identitet katolik. Kur nazistët u bënë thirrje drejtuesve fetarë, që ishin të vetmet figura udhëheqëse pas pushtimit, dhe ata kërkuar të

nënshkruanin një marrëveshje, ku të pranonim që ari që u dërgua në Romë të merrej nga nazistët dhe të dorëzohet listën e hebrenjve. Ata nënshkruan për arin, por jo për hebrenjtë. Merrni arin, harrojeni hebrenjtë. A është vlerë? Mendoj se është vlerë e madhe. Mendoj se fakti që në vendin tone të vogël e të varfër, të hapësh dyert e të strehosh njerëz nuk është diçka që e vë në dyshim, thjesht e bën. Mendoj se është vlerë evropiane, apo jo? Ç'kuptim ka të lësh jashtë këtë hapësirë brenda, këtë zone ku njerëzit ende besojnë shumë tek ideja e bashkimit

në një familje të madhe, por nëse kjo ide shuhet... Ç'ndryshim ka nga një i ri mysliman në rajonin tonë dhe një i ri mysliman në Irak? Ndryshimi është se myslimani ynë ka Evropën, ëndrrën, perspektivën, një mënyrë për të jetuar e kontribuar në botë që shtrihet mbi vlera e tradita. Një mysliman i ri në Irak nuk ka perspektivë. Pra është me rëndësi të kuptohet se ne jemi evropianë, por të qenit pjesë e Bashkimit për ne është çështje përkatësie tani e përgjithmonë te një hapësirë vlerash e njerëzish që është më i miri në botë", tha Rama.

Basha: Shqetësimi i vetëm i Edi Ramës, të vjedhë e të grabisë

TIRANË, 28 KORRIK - Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, bashkëbisedoi me demokratët e Mirditës, ku ngriti shqetësimin se "e vetmja politikë e Edi Ramës është grabitja". "Preokupimi i vetëm i Edi Ramës është si të grabisë, si të vjedhë. Është një hajdut psikik, nuk është një i çmendur apo i marrë, është një hajdut psikik që vjedh çdo gjë që i del përpara. E gjithë qeverisja e tij është vetëm për vjedhje e grabitje. Ai nuk ka asnjë politikë tjetër, prandaj ka vënë grabitjen dhe mbajtjen me dhunë të pushtetit në themel të vjedhjes

dhe grabitjes së shqiptarëve", tha Basha.

Kreu i opozitës vuri në dukje se 30 qershori ishte një mesazh besimi për PD-në, besim që erdhi si rezultat i sakrificave dhe vendimeve të forta, përfshirë edhe djegien e mandateve. "Ruga jonë për ta kthyer refuzimin masiv të 30 qershorit nga një shumicë 'Rama ik' në një shumicë qeverisëse, kalon përmes kulisë së votimit. Për këtë askush nuk ka asnjë iluzion. Qëllimi i protestave ka qenë, është dhe mbetet t'i diktojë kushtet minimale për zgjedhje të lira e të nder-

shme", u shpreh Basha në takim me demokratët e Mirditës, duke vënë në dukje se ky mbetet objektiv i pandryshueshëm për PD-në. "Objektivi ynë politik është i qartë: zgjedhje të parakohshme parlamentare dhe një parlament legjitim të dalë nga vota e mirditorëve dhe vota e shqiptarëve, dhe jo të diktuar nga krimi dhe paraja e drogës. Zgjedhje të garantuara përmes një qeverie transitore, një reformë e thellë elektorale, çuarja para drejtësisë e të gjithë atyre që tashmë i ka dëgjuar e gjithë bota se si shkatër-



ruan zgjedhjet e 2017-s dhe, natyrisht, pas farsës së 30 qershorit, mbajtja në të njëjtën ditë

me zgjedhjet e parakohshme parlamentare, e zgjedhjeve legjitime lokale", tha Basha.

Partitë politike kanë filluar përgatitjet për zgjedhjet e parakohshme parlamentare

Partitë, të hapura për koalicione

Pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj, subjektet politike, përveçse kanë shprehur gatishmërinë për zgjedhje, janë të hapura edhe për koalicione parazgjedhore. Liderët e partive politike të cilët kanë filluar mobilizimin e strukturave partiake për zgjedhje të reja nuk kanë hezitur t'i përmendin edhe emrat e partive me të cilat dëshirojnë koalicione. Disa prej tyre kanë përmendur edhe vija të kuqe. Ndërsa presidenti Hashim Thaçi ka paralajmëruar se këtë javë do t'i fillojë konsultat me partitë politike për ta tejkaluar situatën pas dorëheqjes së kryeministrit të vendit



EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 28 KORRIK - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se këtë javë do t'i fillojë konsultimet me partitë politike për ndërmarrjen e hapave të mëtejshme që çojnë në tejkalimin e situatës së krijuar nga dorëheqja e kryeministrit Ramush Haradinaj. Ndërsa partitë politike kanë filluar përgatitjet për zgjedhjet e parakohshme parlamentare, duke i mobilizuar strukturat e tyre partiake. Në takimet me degët e partive, liderët partiakë dhe zyrtarët e lartë të tyre nuk kanë përjashtuar mundësitë e koalicioneve parazgjedhore, megjithëse disa parapëlqejnë të shkojnë të vetëm në zgjedhje.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) si çdoherë nuk ka vija të kuqe me asnjë parti politike. Anëtari i kryesisë së kësaj partie, Xhavit Haliti, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se koalicionet parazgjedhore do të varen nga konfiguracionet politike. "Do të varet shumë nga konfiguracioni politik i këtyre partive politike. Ne kemi një joshje do të thosha në mes të partive të majta dhe të djathta, sepse të gjithë përcaktohe-

mi në një farë mënyrë se çfarë orientimi politik kanë partitë, por kur është fjala për zgjedhje, harrojnë se a janë të majtë apo të djathtë", ka thënë Haliti.

As Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) nuk ka vija të kuqe, ndonëse parapëlqen koalicion me partitë më të vogla. Lideri i kësaj partie, Ramush Haradinaj, ka thënë se nuk do ta dëshironte një koalicion parazgjedhor me PDK-në, LDK-në dhe LV-në. "Si AAK jemi të hapur të shkojmë në partneritet parazgjedhor me Nismën dhe PSD-në. Jemi kundër koalicionit parazgjedhor me PDK-në, LV-në dhe LDK-në. Nuk po i përjashtoj ata në punë të veta, ne në punët tonat", ka deklaruar Haradinaj.

Edhe Nisma Socialdemokrate është e hapur për koalicione parazgjedhore, ani pse sekretari për marrëdhënie me publikun i Nismës, Endrit Shala, ka thënë për gazetën se parapëlqen që të shkojnë në zgjedhje pa ndonjë koalicion. "Personalisht mendoj se Nisma Socialdemokrate kësaj here duhet të shkojë e vetme në këto zgjedhje, mirëpo për këtë çështje ende nuk kemi ndonjë vendim të organeve partiake. Kjo mbetet të shihet në ditët e

ardhshme. Qëndrim im personal është se duhet të shkojmë të vetëm në zgjedhje, mirëpo vendimin përfundimtar për këtë do ta marrin organet e Nismës Socialdemokrate", është shprehur Shala.

Kurse zyrtari i lartë i Aleancës Kosova e Re (AKR), njëherësh ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka treguar se partia e tij nuk ka vija të kuqe për koalicione parazgjedhore. "Nuk mund të themi se kemi vija të kuqe. Mund të kemi përafërime, ndoshta një harmoni më të mirë programore dhe politike me subjekte të caktuara. Mendoj se vijat e kuqe janë të dala mode", ka deklaruar Matoshi.

Që prej dorëheqjes së kryeministrit as te partitë opozitare nuk ka munguar vullneti për të bashkëpunuar edhe para zgjedhjeve, në mënyrë që të ketë mundësi që qeveria e re të formohet nga subjekte opozitare. Në këtë drejtim, Lëvizja Vetëvendosje është treguar e gatshme për një koalicion

parazgjedhor me LDK-në, por kjo e fundit ka refuzuar.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ali Lajçi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se në parim janë për një bashkëpunim me LDK-në. "Për shkak të interesit të vendit ne do t'i gjejmë të gjitha mundësitë që të bashkëpunojmë dhe ta ndryshojmë gjendjen që Kosova të shkojë drejt një shteti ligjor pa të cilin nuk mundemi. Tani LDK-ja i ka zgjedhjet e brendshme dhe të shohim se kush po fiton. Pra, në parim jemi për bashkëpunim", ka thënë ai.

Mirëpo shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka thënë se kjo parti do të shkojë e vetme në zgjedhje. "Pas zgjedhjeve t'i ndërtojmë koalicionet e nevojshme për të pasur një qeveri jo dy vjet, por një qeveri stabile për katër vjet, me një program të qartë për ta normalizuar vendin dhe për t'i përmbyllur proceset e mëdha që i kemi përpara", ka thënë Hoti, duke përjashtuar çdo mundësi bashkëpunimi me PDK-në.

Edhe Partia Socialdemokrate

ka mbledhur Këshillin Drejtues, ku ka diskutuar mbi rëndësinë e mobilizimit dhe organizimit të strukturave dhe rëndësinë e shpalosjes së pikave programore të platformës socialdemokrate. Sipas PSD-së, kjo do të arrihet me përkushtim dhe gatishmëri për t'u angazhuar maksimalisht në ditët e ardhshme.

Javën e kaluar presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka paralajmëruar se këtë javë do t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në pajtim me kompetencat e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. "Presidenti i Republikës së Kosovës i siguron gjithë qytetarët se çdo veprim i tij do të jetë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe duke filluar nga java e ardhshme do t'i fillojë konsultimet me partitë politike/koalicionet për ndërmarrjen e hapave të mëtejshme që çojnë në tejkalimin e situatës së krijuar nga dorëheqja e kryeministrit", është thënë në një njoftim për medie të Zyrës së Presidentit.

Sejdiu: Jam i gatshëm ta marr përgjegjësinë e liderit të LDK-së

PRISHTINË, 28 KORRIK - Ish-presidenti i Republikës, Fatmir Sejdiu, i ka renditur tri arsye pse ka vendosur t'i hyjë garës për kryetar të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Ai ka thënë se Lidhja Demokratike s'duhet të silltet më në mënyrë inerte përballë zhvillimeve politike. Sipas tij, LDK-së i duhet një rstruk-

turim i mirëfilltë i vetvetes. Po ashtu, ai ka thënë se pastaj partia duhet ta japë një ofertë programore.

Sejdiu ka thënë se është i gatshëm ta marrë udhëheqjen e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Por, ka thënë se gjithçka do të zyrtarizohet në Kuvend. "Siç kam thënë disa herë, unë e

kam shprehur gatishmërinë time që ta marr përgjegjësinë e udhëheqjes së LDK-së. Deri në ditën e mbajtjes së kuvendit unë do t'i analizoj të gjitha rethanat lidhur me kandidaturën time. Ato, siç edhe është rregull, paraqiten në kuvend", ka thënë Sejdiu në një intervistë për "Gazetën Express".



Flet për "Epokën e re", Valdrin Lluka

AKR-ja nuk do ta ketë problemin

- Duhet të shkojmë sa më shpejt në zgjedhje
- Pasojat do të jenë të mëdha nëse dështon projekti i termocentralit 'Kosova e Re'

Ministri në detyrë i Zhvillimit Ekonomik që vjen nga radhët e Aleancës Kosova e Re (AKR), Valdrin Lluka, ka thënë se vendimi për dorëheqje i kryeministrit ishte i papritur për të dhe AKR-në. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se sa më parë duhet të mbahen zgjedhjet e parakohshme që mos të mbesin të bllokuara projektet që e presin Kosovën. Lluka ka bërë me dije se AKR-ja është e gatshme për zgjedhje të reja, duke theksuar se për këtë parti nuk do të jetë problem kalimi i pragut zgjedhor. Sa i përket bashkëpunimit me parti politike, anëtari i kryesisë së AKR-së ka pohuar se nuk kanë vija të kuqe si parti. Në këtë intervistë Lluka ka folur edhe për ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re", për gjendjen në Telekom dhe për ndërmarrjen "Trepça"

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 28 KORRIK -

"Epoka e re": Z. Lluka, ju si ministër dhe zyrtar i lartë i AKR-së si e pritët dorëheqjen e Haradinajt nga posti i kryeministrit?

Lluka: Ishte diçka e papritur kur kuptuam lajmin në mbledhjen e qeverisë për dorëheqje, siç tha ai, për shkak të ftesës nga Gjykata Speciale. Të shohim tani se cilat do të jenë rrjedhat politike, por duhet të mos krijojmë vakum në qeveri. Pa një qeveri e cila nuk ka të drejtë të marrë vendime, dëmet do t'i pësojnë më së shumti qytetarët dhe bizneset.

"Epoka e re": A është e gatshme AKR-ja për zgjedhje të parakohshme?

Lluka: AKR-ja gjithmonë është e hapur për bashkëpunim. Ne nuk vendosim vija të kuqe për askënd sepse jemi parti liberale. Për momentin mendojmë se duhet të shkojmë vetëm në

zgjedhje. Në bazë të analizave që kemi bërë AKR-ja nuk do ta ketë problem kalimin e pragut zgjedhor, ndërkaq sa i përket bashkëpunimit me partitë e tjera kjo do të varet nga mundësitë e bashkëpunimit dhe qasja e partive të tjera, ku hyjnë edhe ofertat. Ta presim caktimin e datës së zgjedhjeve dhe mandej çdo gjë është përcaktues. Mendoj se në zgjedhje duhet të shkojmë sa më shpejt të jetë e mundur dhe mos ta lëmë qeverinë pa një statut të qartë. Sot kur po flasim nuk janë të qarta vendimmarrjet tona. Ka mendime të ndryshme. Disa thonë se ka mundësi për të marrë vendimmarrje, disa të tjerë thonë nuk ka mundësi për vendimmarrje. Është e rëndësishme që të kemi sa më parë zgjedhje të reja.

"Epoka e re": Si rrjedhojë e situatës politike, cilat janë prioritetet që kanë mbetur në mandatin tuaj pa u realizuar?

Lluka: Projekti i termocentralit

"Kosova e Re" është në fazën finale të përmbylljes financiare, ku më pas duhet të dërgohet në Kuvendin e Kosovës për miratim. Këtu mund ta kemi një problem, por me ardhjen e Kuvendit të ri duhet të trajtohet menjëherë kjo çështje. Projektet e tjera që kërkojnë vëmendje është ai për "Trepçën", pasi çdo përpjekje e çfarëdo aseti të "Trepçës", qoftë për shitje apo çfarëdo investimi, kërkon aprovimin e Kuvendit të Kosovës. Kjo është edhe në bazë të Ligjit për "Trepçën". Është procedurë pak e tepërt dhe burokratike por, sidoqoftë, për ta respektuar legjislacionin në fuqi, çfarëdo që dëshirojmë të bëjmë për "Trepçën", duhet aprovimi final në Kuvendin e Kosovës. Si projekt jo më pak me rëndësi kemi edhe Telekomin, që është në një situatë të vështirë. Kemi bërë kërkesë për një garanci shtetërore për ta ndihmuar Telekomin për të pasur një qasje në kredi, sidomos për investimet që i



duhen tani në sistemin e mirëmbajtës së kontrollit dhe formës për pagesën e licencave që skadojnë më 31 korrik dhe ku vazhdon me tjetër licencë për 15 vjetët e ardhshëm. Garancia shtetërore kërkon përfshirjen e Kuvendit, në këtë rast kjo mund të jetë pengesë serioze për Telekomin. Prandaj, janë disa gjëra që Kuvendi i Kosovës na shkakton probleme. Tek pjesa e garancisë jemi duke shikuar meqë është investim brenda Kosovës dhe meqenëse qeveria është aksionare 100 për qind, ndoshta nuk ka nevojë për Kuvendin fare. Këtë çështje jemi duke e shtjelluar bashkë me Ministrinë e Financave, kurse për pjesët e tjera varet nga vendimmarrja e Kuvendit.

"Epoka e re": Në rast se do të dështojë Termocentrali "Kosova e Re", meqë ka kundërshtime të shumta qoftë nga shoqëria civile dhe analistët, cilat do të jenë pasojat për Kosovën?

Lluka: Pasojat do të jenë të mëdha nëse dështon projekti i termocentralit "Kosova e Re". Ne

jemi dëshmitarë që bizneset kanë humbje të mëdha për shkak të energjisë jostabile, qytetarët kanë ndërprerje të vazhdueshme të energjisë dhe kjo ndodh për shkak të paparashikueshmërisë së energjisë elektrike nga termocentralet aktuale. Termocentrali "Kosova A" është ndërtuar në vitin 1962 dhe ai termocentral duhet të jetë një muzë dhe jo termocentral operues, sepse është jashtëzakonisht i vjetër. Punëtorët që punojnë në këtë termocentral janë heronj pasi e mbajnë gjallë atë termocentral. Bazuar në të dhënat e prodhimit të këtij termocentrali shihet se prodhon vetëm për gjysmën e kohës, 40 deri në 50 për qind është aktiv dhe nuk ka mundësi më shumë. Ky termocentral nuk ka stabilitet në prodhim dhe normalisht ndodh shpesh të ndalet dhe mos të operojë, pra shkakton ndërprerje të menjëhershme të energjisë derisa të gjendet mundësia e importimit. Ne kemi nevojë për zëvendësim të kapaciteteve energjetike në vend, pra mbylljen e



m kalimin e pragut zgjedhor



Termocentralit 'Kosova A' dhe aktivizimin me kapacitete të reja që janë më fleksibile dhe shumë më ekonomike dhe eficiente. Termocentrali 'Kosova e Re' i harxhon një ton thëngjill për një megavat prodhim, kurse 'Kosova A' rreth 1.8 ton. Nga kjo mund të kuptohet se sa mund të ketë kursime sa i përket konsumit të thëngjillit. Mendoj se termocentrali 'Kosova e Re' duhet të vazhdojë. Nuk do të ishte problem numri i votave për ta kaluar në Kuvend, pavarësisht situatës aktuale politike.

"Epoka e re": A do të ketë rritje të çmimit të energjisë siç kanë parashikuar disa organizata të shoqërisë civile deri në 50 për qind?

Lluka: Sot kur po flasim për ndikimin në tarifa të energjisë elektrike, kemi parashikime të ndryshme nga shoqëria civile. Fillimisht kishim një të dhënë për rritje çmimi 44 për qind, mandej 60 për qind dhe deri tash së fundi në 90 për qind. Pra, as vetë shoqëria civile nuk ka ndonjë të dhënë të saktë. Të

gjitha këto janë spekulime në bazë të disa kriterëve që ende nuk dihen. Për t'u kuptuar saktë rritja e tarifave të energjisë elektrike ne duhet ta dimë saktë koston e ndërtimit të termocentralit si dhe koston e financimit, tek pastaj ato hyjnë në modelin financiar dhe kuptohet se sa do të jetë kostoja e prodhimit të energjisë elektrike për megavat. Në momentin që paketa e garancive dërgohet në Kuvend, deputetët do të dinë saktë ndikimin në tarifa para se të vendosin. Natyrisht se çdo investim në sektorin energjetik reflekton edhe në tarifa. Edhe energjia e ripërtëritshme, turbinat me erë, panelet solare, investimet në transimion, rrjetë dhe çfarëdo tjetër reflekton në tarifa të energjisë elektrike. Si rrjedhojë, edhe investimi në Termocentralin 'Kosova e Re' do të reflektojë dhe ndikojë në tarifa. Por rritja nuk do të jetë siç po pretendohet nga shoqëria civile. Në fund të fundit, është e rëndësishme që qytetarët dhe bizneset do të kenë furnizim stabil dhe kualitativ të energjisë

elektrike, kjo pastaj do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë edhe në rritjen ekonomike. Pa energji stabile nuk mund të ketë as investitor serioz në vend.

"Epoka e Re": Z. Lluka, si i përgjigjeni paralajmërimit të Sindikatës së "Trepçës" për grevë për shkak të vonësive në paga dhe deri ku ka shkuar me punë grupi punues për çështje sociale?

Lluka: Gjiganti 'Trepça' tani e ka të rregulluar infrastrukturën ligjore pasi në këtë mandat ka kaluar draft-statuti i cili ka mundësuar hapjen e rrugës së zhvillimit të 'Trepçës'. Kam pasur takime me përfaqësues të 'Trepçës' sa herë që ka qenë e nevojshme dhe i kam vizituar ata. Po ashtu, e kemi subvencionuar 'Trepçën' me 5 milionë euro për paga dhe investime, por në tërësi nuk mund t'i subvencionojmë edhe pagat, sepse nuk mund të marrim buxhet nga qytetarët për subvencionim pagash kur dihet se paga mesatare aty është 770 euro. Megjithatë, kjo duhet të bëhet

në bazë të procesit të prodhimit. Sindikata duhet të ulët së bashku me menaxhmentin dhe të koordinohen dhe ta gjejnë mënyrën e rritjes së prodhimit. Në të kaluarën nuk ka pasur problem për sigurim të pagave, andaj natyrisht që menaxhmenti duhet të jetë më agresiv dhe ta rrisë procesin e prodhimit.

"Epoka e Re": Kemi deklarata nga bordi dhe menaxhmenti se prodhimi është i limituar për shkak të teknologjisë së vjetruar. Sa ka interesim për të investuar në "Trepçë"?

Lluka: Teknologjia është vjetruar, por menaxhmenti dhe punëtorët duhet ta bëjnë punën maksimale dhe ta rrisin nivelin e prodhimit në mënyrë që të mund t'i mbulojnë pagat. Interesimi për 'Trepçën' është i vazhdueshëm. Kudo që kam shkuar më kanë përmendur 'Trepçën'. Patëm edhe vizitën në Kanada, ku u shpreh interesim për investime. Po ashtu, kemi edhe një investitor arab që është i interesuar të investojë në 'Trepçë'. Janë diku shtatë investitorë të cilët janë të interesuar për 'Trepçë'-n. Fillimisht është e nevojshme që të bëhet matja e resurseve, pasi që nga viti 1974 nuk ka pasur matje dhe kur të dihet edhe vlera e saktë e resurseve dhe pasurive, atëherë më lehtë do të fillohet me procesin e investimeve të huaja.

Gjendja në Telekom është rënduar

"Epoka e re": Ministër, si është gjendja aktuale në Telekomin e Kosovës dhe kur pritet të fillojë procesi i privatizimit?

Lluka: Gjendja në Telekom është rënduar dhe ka probleme financiare. Ne tashmë jemi në proces të ristrukturimit të Telekomit të Kosovës në bazë të marrëveshjes që kemi me BERZh-in dhe besoj se pas gjashtë muajve Telekom do të jetë në fazën e privatizimit.

"Epoka e re": A mund të ketë infiltrime politike meqë e kemi dhe rastin e "Z-Mobile"-s?

Lluka: Jo. Arsyeja kryesore pse kam insistuar në angazhimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për të na ndihmuar në procesin e ristrukturimit dhe privatizimit të Telekomit është pikërisht rritja e kredibilitetit të procesit si dhe konkurrueshmëria nga kompani me brende ndërkombëtare. Vetë fakti që një institucion kredibil është i përfshirë në këtë asistencë, përçon mesazh serioz dhe pozitiv drejt

aktorëve të ndryshëm.

"Epoka e re": Si e keni parë paralajmërimin e IPKO-s për largim nga Kosova?

Lluka: IPKO është një ndër investitorët më të mëdhenj të huaj në Kosovë. Normalisht, vendimarrjet strategjike janë të kompanisë dhe një gjë e tillë mund edhe të jetë pozitive për Kosovën, varësisht se kush është blerësi i telefonisë mobile. Unë pres që çmimi i investimit është jashtëzakonisht i madh, që vetëm investitorë të huaj seriozë do të tregojnë interesim. Nëse një gjë e tillë ndodh, atëherë edhe mund të kemi brende të mëdha ndërkombëtare në Kosovë si rrjedhojë e këtij transaksioni. Kjo, po ashtu, do të ndikojë pozitivisht në rritje të investimeve të huaja direkte pasi që çmimi i shitjes së këtij aseti pritet të jetë shumë më i madh se investimi i realizuar dhe neto vlera është përfitim për bruto-prodiktin vendor të Kosovës.

Asfaltohet rruga që lidhë katër lagje në Banjë

MALISHEVË, 28 KORRIK (ER) - Në fshatin Banjë të Malishevës po asfaltohen afër 700 metra rrugë, që lidhin katër lagje të këtij fshati Shurdhaj, Elshani, Buzhala dhe Limaj, të cilat deri më tani e kanë pasur problem lidhjen mes vete me rrugë, ndonëse janë afër njëra-tjetrës, por nga e shtuna përfundimisht është zgjidhur edhe ky problem.

Asfaltimin e rrugës e kanë parë nga afër kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, dhe nënkryetari Hajdin Berisha, të cilët janë takuar edhe me kryesinë fshatit dhe banorët e lagjeve. Me këtë rast, banorët e kanë falënderuar komunën për asfaltimin e rrugës dhe zgjidhjen e problemit të qarkullimit

dhe lidhjes së lagjeve. "Këto investime janë në kuadër të investimeve në infrastrukturën rrugore, që jemi duke realizuar në tërë territorin e Komunës së Malishevës dhe, fatmirësisht, tanimë jemi duke investuar në rrugë brenda lagjeve apo që lidhin lagjet mes vete, si në këtë rast", ka thënë nënkryetari Berisha, duke shtuar se realizimi i projekteve në infrastrukturën rrugore janë pjesë e investimeve në projekte kapitale, kryesisht në infrastrukturë. "Si qeverisje komunale jemi të përkushtuar që t'i realizojmë të gjitha objektivat e parapara dhe të gjitha projektet e planifikuara", ka thënë Berisha gjatë takimit me banorët e këtyre lagjeve.



Asfaltohen rrugët 'Vëllezërit Dehiri' dhe 'Besnik Muçaj' në Prizren

PRIZREN, 28 KORRIK (ER) - Në kuadër të punimeve për rehabilitim të rrugëve me asfalt në Komunën e Prizrenit, Drejtoria e Shërbimeve Publike vazhdon të punojë intensivisht për përmirësimin e infrastrukturës rrugore. Sipas një njoftimi të kësaj komune, në rrugën "Vëllezërit Dehiri" është bërë përmirësimi i nyjave sanitare, asfaltimi dhe rehabilitimi i ujësjellësit me gjatësi 240 metra dhe me gjerësi tri metra, ndërsa në rrugën "Besnik Muçaj" është bërë



shtruarja e asfaltit me gjatësi 143 metra dhe gjerësi tri metra. Si pjesë e realizimit të punimeve në këtë të fundit është edhe ndërtimi i sistemit të ujësjellësit, kanalizimit fekal dhe atmosferik, si dhe instalimi i ndriçimit publik.



Në Prishtinë është mbajtur finalja e kuisit të diturisë

PRISHTINË, 28 KORRIK (ER) - Organizuar nga Ministria e Diasporës, në Prishtinë është mbajtur finalja e kuisit të diturisë, në të cilin morën pjesë nxënësit e shkollave shqipe nga diaspora, përkatësisht fituesit e kuisive nga Austria, Zvicra, Italia dhe Greqia. Ata iu përgjigjen pyetjeve nga gjuha e

letërsia shqipe, kultura, historia dhe gjeografia. Përmes këtij kuisi ata shpallën njohuritë për gjuhën, kulturën dhe historinë e popullit shqiptar, njohuri këto që marrin nga mësuesit, të cilët me përkushtim dhe pa u lodhur punojnë me ta. Meqë ky kuis nuk pati karakter

garues, po më shumë edukues e shoqëruues, nuk pati humbës. Të gjitha grupet u shpallën fituese. Finalja e kuisit u përshkua edhe me pika muzikore dhe me një pikë baleti. Pas kuisit, pjesëmarrësit e kuisit vizituan Muzeun Kombëtar, ku u njohën me eksponatet e periudhave të ndryshme historike.

Gjendja e sigurisë në Deçan, e qetë

DEÇAN, 28 KORRIK (ER) - Gjendja e sigurisë në Komunën e Deçanit është e qetë. Kështu është bërë me dije në mbledhjen e tretë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), ku ishte i pranishëm edhe kryetari i kësaj komune, Bashkim Ramosaj. Në këtë mbledhje është diskutuar për çështjen e sigurisë në Komunën e Deçanit, për mërgimtarët; ofrimin e shërbimeve, sigurinë dhe ngjarjet kulturore etj., për parandalimin e keqpërdorimit të ujit të pijes për sezonin veror dhe për shqyrtimin e draftplanit të punës së KKSB-së për vitin 2019. Komandanti i Stacionit Policor në Deçan, kapiten Faik Jahmurataj, ka vlerësuar se gjendja e sigurisë në Deçan është e qetë. Sipas tij, rastet e vjedhjeve kanë rënë dukshëm. Ai njëkohësisht ka kërkuar që të rritet bashkëpunimi në mes të Drejtorisë së Inspeksionit në

sezonin veror gjatë inspektimeve të përbashkëta. Po ashtu, edhe drejtori i Inspeksionit, Halil Tolaj, ka thënë se kanë rritur bashkëpunimin me policinë gjatë inspektimeve të përbashkëta, ku ka konfirmuar se kanë mbyllur dy lokale të jashtëligjshme në Komunën e Deçanit dhe ka paralajmëruar se janë në procedura për aprovimin e rregullores për

respektimin e orarit të punës. Ndërsa koordinatori i KKSB-së, Ismet Kukleci, ka thënë se vazhdon të mbetet shqetësuese rruga e cila kalon para Manastirit e cila ka krijuar një huti dhe pa siguri të qytetarët ku brenda 100 metrave rrugë duhet të kalohet mbi 13 pengesa rrugore (policë të shtrirë). Ai ka thënë se kjo është pengesë për lirinë e lëvizjes së qytetarëve.



Në Bajgorë u mbajt 'Dita e Mërgatës'

VUSHTRRI, 28 KORRIK (ER) - Në kuadër të Ditëve të Diasporës është mbajtur të dielën në Shalë të Bajgorës 'Dita e Mërgatës', e organizuar nga Ministria e Diasporës dhe Investimeve

Strategjike (MDIS), në bashkëpunim me Komunën e Mitrovicës dhe Vushtrrisë. Në emër të ministrit Dardan Gashi të pranishmit i ka përshëndetur këshilltari politik i tij,

Muhamet Selmani, i cili ka theksuar se Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike i ka dhënë mbështetje në vazhdimësi diasporës shqiptare.

Dita e mërgatës u përcoll me program artistik, ku performoi Ansambli "Mitrovica" dhe me pika të ndryshme u paraqitën rapsodë dhe grupe të tjera folklorike.



Zgjedhjet e parakohshme do t'i kushtojnë Kosovës 4 deri në 5 milionë euro

Sipas llogaritjeve të para, zgjedhjet e parakohshme, krahasuar me shumën e shpenzuar gjatë zgjedhjeve të vitit 2017, mund t'i kushtojnë Kosovës nga 4 deri në 5 milionë euro. Valmir Elezi, zëdhënës i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ka bërë me dije se për zgjedhjet parlamentare të 11 qershorit të vitit 2017, kostoja ishte 4 milionë euro dhe në rast të mbajtjes së zgjedhjeve këtë vit, kostoja pritet të jetë e njëjtë



PRISHTINË, 28 KORRIK - Që nga viti 2010 asnjë qeveri e Kosovës nuk ka arritur ta përfundojë mandatin kushtetues katërvjeçar që si pasojë ka imponuar organizimin e zgjedhjeve të parakohshme. Përveç efekteve politike, shkuarja e shpeshtë në zgjedhje, sipas organizatave joqeveritare, po i kushton edhe buxhetit të Kosovës me harxhimin e paplanifikuar të miliona eurove.

Këtë vit në Kosovë u organizuan zgjedhje të jashtëzakonshme lokale në katër komunat veriore, pas dorëheqjeve të katër kryetarëve të atyre komunave. Për organizimin dhe mbajtjen e këtyre zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pati konfirmuar se ishin shpenzuar më shumë se 471 mijë euro. Aktualisht, Kosova nuk është në proces zgjedhor, por është në prag të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj. Bazuar në qëndrimet e shprehura, partitë politike janë deklaruar se i preferojnë zgjedhjet e parakohshme dhe po presin nga presidenti i Kosovës që t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme kushtetuese e ligjore.

Sipas llogaritjeve të para, këto zgjedhje, krahasuar me shumën e shpenzuar gjatë zgjedhjeve të vitit 2017, mund t'i kushtojnë Kosovës nga 4 deri në 5 milionë euro.

Mexhide Demolli-Nimani, drejtoreshë e Lëvizjes FOL, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se kostoja e cila mund të përdoret për mbajtjen e zgjedhjeve është rreth 5 milionë euro çka, sipas saj, nuk është aspak e vogël. "Ndonëse ende nuk po dihet saktë nëse do të ketë zgjedhje apo jo, mund të them se tri qeveritë e kaluara nuk kanë arritur ta përfundojnë mandatin e tyre deri në fund, duke bërë që vendi gjatë këtyre gati 10 vjetëve të fundit të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme. Sipas të dhënave të KQZ-së për zgjedhjet e kaluara janë shpenzuar rreth 5 milionë euro, e që mendojmë se nuk është shifër e vogël, e aq më pak kur nuk parashikohen në buxhetin e këtij viti. Se sa do të shpenzohen për këto zgjedhje nëse mbetet të shihet", ka thënë Demolli-Nimani.

Në anën tjetër, Valmir Elezi, zëdhënës i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Kosovë, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se viti 2019 nuk është vit zgjedhor

dhe se në Ligjin për buxhet të këtij viti nuk ka mjete të planifikuara për mbajtje të zgjedhjeve. "KQZ-ja mund të fillojë të përgatitet për zgjedhjet e ardhshme vetëm pasi ato të shpallen nga presidenti dhe se në këtë drejtim ende nuk është bërë ndonjë planifikim. Viti 2019 nuk është një vit zgjedhor, çka do të thotë se në Ligjin e buxhetit për këtë vit nuk ka mjete të planifikuara për zgjedhje. Nëse do të ketë zgjedhje, sepse ne po flasim vetëm në rast se do të ketë zgjedhje të jashtëzakonshme, duke u mbështetur edhe në praktikën e situatave pak a shumë të ngjashme, KQZ-ja bën kërkesë buxhetore në qeveri për mjete financiare për mbajtjen e zgjedhjeve. Për shembull, kështu kemi vepruar së fundmi me

zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë të katër komunave, të cilat u mbajtën më 19 maj të këtij viti", është shprehur Elezi. Po ashtu, ai ka thënë se për zgjedhjet parlamentare të 11 qershorit të vitit 2017 kostoja ishte 4 milionë euro dhe në rast të mbajtjes së zgjedhjeve këtë vit, kostoja pritet të jetë e njëjtë. Ndërkaq Artan Murati nga Instituti Demokratik i Kosovës thotë për "Radion Evropa e Lirë" se mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme do të shkaktonte problem në aspektin e shpenzimeve. "Duke pasur parasysh pozicionin ekonomik të Republikës së Kosovës, një prej vendeve më të varfra në Evropë, konsideroj se këto zgjedhje pa dyshim paraqesin telashe edhe në aspektin financiar edhe në aspektin e shpenzimeve. Nëse e

bëjmë një analogji me zgjedhjet e kaluara, do të thotë vetëm në vitin 2017 Kosova ka harxhuar rreth 10 milionë euro për zgjedhje. Pasi që ka pasur zgjedhje të jashtëzakonshme për Kuvendin, ka pasur zgjedhje lokale në dy raunde, madje në Istog ka qenë edhe raundi i tretë. Kjo është një shumë e madhe parash", ka thënë Murati. Sipas tij, po të shfrytëzohej një shumë e tillë e parave për çështje të tjera, me theks të veçantë për investime ose për projekte kapitale, kjo gjë do të ishte më e mirëseardhur sesa "të paguhen lojërat politike të subjekteve politike që bëjnë me njëra-tjetrën".

Gjatë vitit 2017, sipas të dhënave të KQZ-së, Kosova kishte shpenzuar mbi 11 milionë euro për organizimin e zgjedhjeve lokale dhe atyre parlamentare.

Haradinaj mori pjesë në meshën e shugurimit të Kishës së Shën Ndout

Glllogjan, 27 korrik (ER) - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë në meshën e shugurimit të Kishës së Shën Ndout, në Glllogjan të Komunës së Pejës. Me këtë rast, Haradinaj ka thënë se është nder për të që merr pjesë në këtë meshë, duke revokuar kujtimet e fëmijërisë së tij në këtë kishë.

Kryeministri në detyrë, Haradinaj, ka pohuar se i gjithë populli i kësaj ane e ka pasur shpresë këtë kishë, pa dallim besimi. Një tjetër ngjarje, që kryeministri në detyrë, Haradinaj, ndau para të pranishmëve, ishte ajo e dëshmorit Nika, i cili u vra në luftë, në mbrojtje të familjes së tij, të vendit të tij dhe të cilit nderimin e fundit ia ka bërë meshtari i kësaj kishë.

Kryeministri në detyrë, Ramush

Haradinaj, gjatë fjalës së tij ka thënë se të gjitha këto u përmenden për shkak se është një listë e gjatë e jetës në besim, në vlera e identitet dhe këtë më së miri e dëshmon fakti se shqiptari nga cilado krahinë sot mburret me Skënderbeun e me Nënë Terezën. "Ky fakt na bënë të besojmë se jo vetëm që do të ecim rrugës drejt së drejtës sonë dhe ta ruajmë veten ashtu siç kemi ditur ta ruajmë qindra vjet, por do ta nderojmë edhe familjen e madhe evropiane e euroatlantike", është shprehur Haradinaj, duke uruar ndërtesën e re të Kishës në Glllogjan dhe qytetarëve të kësaj ane një jetë në paqe.

Ipeshkvi i Ipeshkvisë së Kosovës, Imzot Dodë Gjergji, pasi ka falënderuar të gjithë ata që kontribuuan për ndërtimin e kësaj



kishe, iu dëshiroi mirëseardhje në këtë akt solemn, të kësaj ngjarje që, siç tha, në pamjen e parë është diçka e thjeshtë, por që solemnisht dëshirojnë ta shfaqin ndjenjën për atë çfarë kanë bërë. "Si popull mund t'i kushtojmë

zotit 300 vjet gjak, martirë, vuajtje dhe persekutim të Perandorisë Romake dhe 500 vjet vuajtje dhe sakrificë të Perandorisë Osmane, si dhe 100 vjet vuajtje dhe sakrificë mbretërisë serbe, kroate e slovene, por populli ynë ka edhe

gabimin e mëkatit e vet, që duhet t'ia kushtojë Zotit", ka thënë Imzot Dodë Gjergji.

Një fjalë para të pranishmëve mbajti edhe famullitari i Kishës së Glllogjanit, Don Pal Tunaj dhe Don Fran Kola.

Për një koncept të mirëfilltë urbanistik-arkitektonik për shtatoren e Adem Demaçit



Nga: Arianit BYTYÇI,
arkitekt

Shtatorja e simbolit të rezistencës kombëtare Adem Demaçi duhet të vendoset në një lokacion më kuptimplotë në aspektin simbolik dhe arkitektonik-urbanistik. Hapësira publike ku do të duhej të vendosej shtatorja, domosdoshmërisht duhet të jetë e ndërlidhur urbanistikisht me hapësira e tjera publike, që do ta inkurajonte komunikimin dhe ndërveprimim mes njerëzve. Të jetë një hapësirë publike ku qytetarët, studentët, profesorët, vizitorët vendorë dhe ndërkombëtarë të kryeqytetit do të ecnin e do të komunikojnë çdo ditë.

Në hapësirën publike ku duhet të planifikohet vendosja e shtatores së Adem Demaçit duhet të ndodhë komunikim dhe aktivitete dinamike, duhet të jetë hapësirë publike vibrante dhe domethënëse, e jo të jetë një "ishull" i izoluar, siç është përzgjedhur aktualisht, i cili nuk mundëson ndërlidhjen me hapësira të tjera publike, me sheshe e me bulevarde të tjera. Shikuar nga këto kritere bazike urbanistike, shtatorja e Adem Demaçit mund të vendoset në hapësirën pranë Bibliotekës Kombëtare të Kosovës apo edhe në hapësirën e fillimit të Bulevardit "Nënë Tereza", pranë kompleksit universitar,



hapësirë kjo që pritet të shndërrohet në bulevard për këmbësorë, sipas planit rregullues urban në fuqi.

Adem Demaçi, mbi të gjitha, ka qenë njeri i dijes dhe guximit, simbol i lirisë, demokracisë,

sakrificës dhe i emancipimit, ka qenë shkrimtar. Prandaj, edhe meriton që shtatorja e tij të ngrihet në hapësira publike që promovojnë dijen dhe emancipimin.

Për të realizuar këtë qëllim,

institucionet përgjegjëse duhet të shpallin konkurs ndërkombëtar të arkitekturës për projektimin e hapësirës publike ku planifikohet vendosja e shtatores së Adem Demaçit dhe krahas kësaj të shpallet

konkurs ndërkombëtar për idenë e shtatores.

Çdo vendimmarrje tjetër, në mënyrën siç ka ndodhur deri më tani nga institucionet përgjegjëse, është improvizim klasik ballkanik.

Tri llojet e shtetit social



Shkruan: Sabri KIÇMARI

Shoqëria e Kosovës karakterizohet me gjendje të rëndë sociale, shkallë të lartë të papunësisë, rritje të ulët ekonomike dhe dëshpërim i madh shoqëror nga politika dhe shteti. Politika nuk ka arritur të krijojë një fundament për punësim dhe rritje

ekonomike solide. Mungesa e një sistemi të shtetit të mirëqenies sociale ka bërë që të mos ketë shpërndarje racionale të të mirave publike. Kjo ka pasur për pasojë rritjen e diferencave në mes të shtresave shoqërore. Zgjedhjet e reja janë një shans e mirë për subjektet politike për t'i rishqyrtuar tezat e tyre themelore programore në lidhje me sistemin ekonomik dhe social të vendit tonë. Në vend që subjektet politike të harxhojnë më shumë kohë për tema të tilla, ato përqendrohen në tema joproduktive (p. sh., dialogu me Serbinë), pa përmbajtje dhe bëjnë premtime pa mbulesë (p.

sh. liberalizimi i vizave). Ato do të duhej të harxhonin kohë për t'i analizuar mundësitë e reformimit të sistemit tonë ekonomik dhe social.

Këtu po paraqes në variant të shkurtër tri llojet e shteteve sociale në botën perëndimore:

1. Modeli socialdemokratik skandinav i shtetit social përqendrohet në një përkujdesje dhe shpërndarje të gjerë sociale. Këtu kemi të bëjmë me principin e barazisë së të gjithë anëtarëve të shoqërisë pavarësisht kontributit dhe statusit të tyre në shoqëri. Ky model është një lloj modeli universal i shtetit social. Në këtë sistem

synohet zvogëlimi i diferencave në të ardhura përmes shpërndarjes egalitare të të mirave publike. Ky model dominon në Suedi.

2. Modeli konservativ kontinental evropian bazohet në sigurimet sociale, pensionet, sigurimin nga papunësia dhe sëmundja. Synim i shtetit është ruajtja e standardit social. Tiparet dalluese të këtij modeli janë: ka një përqendrim të theksuar në sigurimin social përmes punës me pagë, të bazuar në përkatësinë klasore dhe statusin shoqëror dhe familjar. Ky model dominon në Gjermani.

3. Modeli liberal anglosakson.

Te ky model dominon logjika e tregut dhe sigurimit privat. Sipas këtij modeli vendoset primati i përgjegjësisë vetjake dhe nuk preferon rrjet të fortë të sigurisë sociale. Ky model dominon në ShBA.

Qytetari i Kosovës është punëtor. Ai është në gjendje të kryejë obligimin e tij në raport me shoqërinë, familjen dhe veten e vet, nëse i jepet mundësia të punojë. Fakti se ai është i papunë është problem strukturor dhe jo faj i tij. Partitë politike duhet të analizojnë me kujdes dhe të përcaktohen për variantin e preferuar për kushtet e Kosovës.

Arka e shtetit për gjashtë muaj grumbulloi rreth 900 milionë euro

Dy institucionet që kontribuojnë më së shumti në buxhetin e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës, në gjashtëmuajorin e parë të këtij viti kanë treguar performancë të mirë në mbledhjen e të hyrave për arkën e shtetit. Sipas zyrtarëve të Doganës së Kosovës taksa 100 për qind e vendosur nga Qeveria e Kosovës për produktet me origjinë nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina, ka pasur efekte në mbledhjen e të hyrave

PRISHTINË, 28 KORRIK - Dy institucionet që kontribuojnë më së shumti në buxhetin e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës, thonë se brenda gjashtë muajve kanë treguar performancë të mirë në mbledhjen e të hyrave për arkën e shtetit. Sipas projeksioneve të Qeverisë së Kosovës, nga të hyrat doganore për buxhetin e vendit gjatë këtij viti duhet të grumbullohen mbi 1.2 miliard euro, ndërsa nga Administrata Tatimore e Kosovës mbi 500 milionë euro. Zëdhënësi i Doganës së Kosovës, Adriatik Stavileci, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se presin që t'i tejkalojnë parashikimet e Qeverisë së Kosovës për mbledhjen e të hyrave për vitin 2019. Ai ka bërë me dije se që nga janari deri më tani, kanë arritur të mbledhin mbi 600 milionë euro. "Dogana e Kosovës jo vetëm këtë vit, por edhe gjatë viteve të kaluara ka arritur t'i tejkalojë parashikimet. Derisa në vitin

2018 në periudhën e njëjtë kohore janar-korrik janë mbledhur 585 milionë euro, në këtë vit janë deri në 615 milionë. Pra, kemi një rritje për 30 milionë euro. Në aspektin e projeksioneve, deri në fund të vitit duhet mbledhur 1.2 miliard euro dhe ne besoj që jemi në rrugë të mirë dhe deri në fund të dhjetorit do të përmbushim 99 për qind ose 101 për qind në projeksionet e parapara nga Qeveria e Kosovës në fillim të muajit janar të vitit 2019", ka deklaruar Stavileci. Ai ka treguar se taksa 100 për qind e vendosur nga Qeveria e Kosovës për produktet me origjinë nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina ka pasur, po ashtu, efekte në mbledhjen e të hyrave. Stavileci ka sqaruar se brenda një kohë të shkurtër, produktet që vinin nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina, u zëvendësuan me produktet që vinin nga vendet e tjera gjë, sipas tij, bëri të mos ndikohet në rënien e të hyrave. "Nuk mund t'i shmangim efek-



tet që ka shkaktuar taksa. Një pjesë e madhe e mallrave të cilat kanë ardhur nga Serbia janë zëvendësuar me importe nga vendet e tjera. Një aspekt që ka ndikuar taksa është se me Serbinë kemi pasur vetëm Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe nuk kemi pasur taksë doganore, ndërsa mallrat nga vendet e tjera kanë pasur edhe taksë doganore, por në shumicën e importeve që janë zëvendësuar kanë qenë nga Bashkimi Evropian, që prapë ndikohen nga Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit, që nënkupton taksë doganore të reduktuar", ka theksuar ai. Performancë të mirë në mbledhjen e të hyrave ka treguar edhe

Administrata Tatimore e Kosovës. Ditë më parë, në një konferencë për media, drejtori i ATK-së, Ilir Murtezaj, ka bërë me dije se të hyrat nga tatimet për periudhën gjashtëmuajore janë arritur në vlerën në 239,5 milionë euro. Ai ka theksuar se krahasuar me vitin 2018 janë mbledhur 19.5 milionë euro më shumë. "Një ndër elementet kyçe që ka ndikuar në rritjen e të hyrave ka të bëjë me mbledhjen e borxheve dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me luftimin e evazionit fiskal", ka thënë Murtezaj. Ministri në dorëheqje i Financave, Bedri Hamza, është deklaruar se Kosova ka pozitë të

qëndrueshme makrofikale dhe se trendi i të hyrave është në përputhje me planifikimet. Ai ka thënë se është optimist që parashikimet në mbledhjen e të hyrave për arkën e shtetit do të realizohen. "Nëse i referohemi parasë së gatshme në llogari gjendja jo që është dobësuar, por është përmirësuar, dhe ne nuk kemi asnjë vonesë në asnjë pagesë, as për pensione, as për çështje të tjera sociale, as për paga e as për projekte kapitale. Shteti ka para", ka thënë Hamza. Administrata Tatimore dhe Dogana e Kosovës janë kontribuuesit kryesorë të buxhetit të shtetit, i cili në këtë vit kap vlerën prej 2.3 miliardë eurosh.

Sigurimet sipas çmimit të automjeteve

Banka Qendrore e Kosovës (BQK) pritet që gjatë muajit gusht të marrë vendim në lidhje me kërkesën e kompanive të sigurimeve për rritjen apo jo të çmimeve për sigurimin e automjeteve. "Radio Kosova" merr vesh se opsioni më i pranueshëm dhe që mund ta marrë dritën e gjelbër është që veturat më të shtrenjta të paguajnë sigurim më të lartë

PRISHTINË, 28 KORRIK - Rritja e çmimeve për sigurim të automjeteve është temë e përfolur kohën e fundit, mirëpo si Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ashtu edhe Shoqata e Sigurimeve janë të rezervuara të japin më shumë hollësi në lidhje me këtë çështje. Zëdhënësi i BQK-së, Kushtrim Ahmeti, ka thënë për "Radio Kosovën" se nuk është marrë ndonjë vendim për këtë gjë. "Aktualisht nuk ka rritje të çmimeve të sigurimit të automjeteve. Ashtu siç ka bërë edhe në të kaluarën, për çdo vendim të ri Banka Qendrore e

Republikës së Kosovës do ta njoftojë publikun", ka thënë Ahmeti. Edhe Shoqata e Sigurimeve të Kosovës ka dërguar përgjigje me shkrim ku nuk ofron ndonjë risi. Kjo shoqatë potencon se çështja e ndryshimit të çmimit të sigurimit është çështje individuale e secilës kompani të sigurimit dhe se nuk është në dijeni nëse ka ndonjë kërkesë të tillë të paraqitur nga siguruesit. Por "Radio Kosova" mëson se kompanitë e sigurimeve kanë dorëzuar në BQK kërkesën për rritjen e çmimeve. "BQK-ja pritet të vendosë në muajin



gusht në lidhje me çështjen", ka thënë ky burim për "Radio Kosova". Çmimet e sigurimeve mund të rriten deri në rreth 30 për qind

për automjete të reja, e automjetet e lira do të kenë çmim më të lirë. Sepse sipas zyrtarëve, nuk ka kuptim që një veturë me vlerë 100 mijë euro të paguajë

sigurim të njëjtë sikur një "Golf 2". Kjo formë mësohet se është e pëlqyeshme si nga shoqatat e sigurimeve, po ashtu e pranueshme edhe nga BQK.

Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (5)

ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

- Përshtypjet në "librin e zisë"



**Përgatiti Selatin
NOVOSELLA**

I përjetshëm kujtimi për Ty Bacë!
Pikëllim i thellë na ndjek, por
krenaria është e madhe që të
patëm! Lamtumirë Bacë!

27 korrik 2018,
Gani Mustafë Fetaj

Adem Demaçi,
Ishe udhëheqësi i të gjithë
brezave. Ishe luftëtari më i madh
i lirisë së Kosovës!

27 korrik 2018,
Jusuf Berisha, Podujevë

Nderim të përhershëm njeriut që
ndërtoi historinë! Nderim
Kolosit të kohës që i dha kuptim
historisë së Re të Kombit!
Lamtumirë Baca Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
Masar Bushi

Nderimet më të larta për
Legjendën e Kosovës dhe të
gjithë shqiptarisë. Je i pavdek-
shëm! Lum populli që të ka!

27 korrik 2018,
Familja Berisha nga Dyzi

Shkove Baca Adem, por kujtimi
për ty do të jetë i përhershëm!
Do të mbetesh përherë në
zemrat tona, Heroi Ynë!

27 korrik 2018,
Gani Mustafa

Ishe dhe do mbetesh frymëzimi
më i lartë për liri e bashkim kom-
bëtar. Ne rinia të gjithë jemi bru-
mosur me idealin e Bacës Adem.
Rinia e tashme do vazhdojë të ruaj
e kultivojë ndjenjat kombëtare
ashtu siç na keni mësuar ju Bacë
me veprat tuaja që i njohu bota.

27 korrik 2018,
Rinia Demokratike e Kosovës

Me veprën tënde u bërë i
pavdekshëm! Qofshim ne shqip-
tarët pasardhësit tuaj të pjekur
që të mësojnë nga ndriçimi yt!

27 korrik 2018,
Fisnik Latifi

?
Lavdi Baca Adem!

27 korrik 2018,
Sejdi Gashi

Lavdi simbolit të rezistencës
kombëtare-të qoftë i lehtë dhe i
Kosovës!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Lavdi Baca Adem, Të qoftë i lehtë
dhe i Kosovës që aq shumë e
deshe!

27 korrik 2018,
Nazmi (mbiemri i palexueshëm)

Vështirë qenka të shkruash në
këtë fletore, por sidoqoftë s'kemi
çka të bëjmë! Lavdi për gjithë atë
që bëre për këtë popull - i lehtë të
qoftë dhe i tokës nënë.

27 korrik 2018,
Me respekt Bajram Ismaili,
Prishtinë

Lavdi për veprën tuaj Adem
Demaçi! Të qoftë i lehtë dhe i
Kosovës!

27 korrik 2018,
Nexhmedin Nasolli

O Baca Adem, o shqiptar i madh
i shekujve! O simboli i rezis-
tencës kombëtare, për liri,
drejtësi e paqe në botë, do të
mbetesh për jetë në mendjet
tona. Na mësove si të punojmë
dhe ta duam atdheun tonë.

27 korrik 2018,
Prof. dr. Isuf Musliu, Prishtinë

Nderime dhe respekt të pafund
për veprimtarin, humanistin dhe
kritikun e hollë, simbolin e
Kombit Shqiptar! Shprehim

ngushëllimet në emër të
Agjencisë së Statistikave të
Kosovës!

27 korrik 2018,
Isa Krasniqi, Ismet Tahiri, Sanije
Tahiri

Lavdi jetës dhe veprës së Bacës
Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
Zef Berisha

Megjithatë, mbi të gjitha ishe
njeri i madh që lindët rrallë!

27 korrik 2018
(emri i palexueshëm)

Baca, simbol i rezistencës
intelektuale!

27 korrik 2018,
Adem Nura, Isamil Smakiqi,
Muhamet Hajrizi...

Ishe dhe mbete ëndrra për liri e
bërë realitet e një populli të tërë.
Ishe shpresa e pashuar dhe e
palëkundur për liri! Duke qenë
njeri i zakonshëm u bërë institu-
cion i lirisë së shqiptarëve. I për-
jetshëm do të jetë kujtimi për Ty!

27 korrik 2018,
Valon Murati, LB

Baca Adem jeni i nderuar për
gjithmonë!

27 korrik 2018
(emri i palexueshëm) Zeka

Jemi të nderuar me Ju si njeri
çfarë ke qenë Ti!



27 korrik 2018,
Feride Gjoka

Jam i nderuar që kam jetuar dhe
bashkëvepruar me Juve! Me
respekt e kujtim të përjetshëm!

27 korrik 2018,
Avdi Imeri

Juve që na dhatë jetë, që na mba-
jtët gjallë, Lavdi! I paharruar kuj-
timi, e pavdekshme vepra juaj,
Nderi i Kombit Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
Fehmi Blakçori

Lavdi jetës dhe veprës suaj! Baca
Adem, u prehsh i qetë në tokën e
Kosovës!

27 korrik 2018,
Murat Kapiti

Baca Adem,
Ne, bijtë tuaj, të kujtojmë për
jetë, si Babin e Kombit! Ishe
frymëzimi i çështjes kombëtare!
Ngushëllime tërë Kombit shqip-
tar!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Jeta dhe vepra juaj është HISTO-
RIA JONË!

27 korrik 2018, Ismail Gjoshi

Koha dhe hapësira janë relative,
por vepra e Bacës do të jetë
absolute në mendjet dhe
shpirtin tonë, si e shenjtë!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Sot gjatë homazhit mu kujtua një
fjalë që ma the kur u takuam;
Mua më respekton, nëse ma
respekton kombin", ishin fjalët
tuaja.

27 korrik 2018,
Burim Krasniqi

Ishe i madh dhe i madh do të
mbetesh! Zoti të mëshiroftë, o
Baca Adem!

27 korrik 2018,
Adem (mbiemri i palexueshëm)

Me nderime BACË!
Ishalla Allahu në xhenet na
bashkon me nderime të larta,
shoku i paharruar Adem
Demaçi!

27 korrik 2018,
Aziz Latifi

Lavdi të qoftë për mundin që ke
dhënë për çështjen kombëtare
shqiptare. Iu nderon Shoqata
shqiptare SHKA "Shqiponjat e
Medvegjës"!

27 korrik 2018,
Selman Rexhepi

Baca Adem Demaçi, me dhemb-
je pritem lajmin për ndërrim
jete! Ndjehe mi krenar për jetë e
mot që të patëm prijës lirie, qën-
drese dhe lufte për çlirim e
bashkim kombëtar.

27 korrik 2018,
Xhevat Haziri

Për TY dhe Atdheun kurrë nuk
është mjaftë, ia vlen edhe të
vdesësh!

27 korrik 2018,
Isa (mbiemri i palexueshëm)

Bacë, ideali i juaj për liri të atd-
heut u bë betim i yni. Lavdi për
jetë e mot!

27 korrik 2018,
(emri i palexueshëm) Fetahaj,
Pejë

Ishe dhe mbetesh frymëzimi i
madh i çdo fëmije të dëshmorit o
Heroi Im, ideali jonë për
Shqipërinë Etnike!


27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Lavdi për jetë veprës së
Legjendës sonë shqiptare, Heroit
tonë shqiptar Adem Demaçi!
Rroftë Shqipëria e Madhe!

27 korrik 2018,
Azem Haxhiu, Drenicë

Lavdi veprës së ADEM
DEMAÇIT! Nga sot ai është në
përjetësi! Do ta kujtojmë për jetë
e mot!

27 korrik 2018,
Mexhid Mehmeti




Faksimil i përshtypjes të Kadri Veselit,
Kryetari i Kuvendit të Kosovës

(Vazhdon në numrin e
ardhshëm)

Fizika simetrike, udhëtim drejt universit (12)

Atomi, ngjashmëria ndërmjet protoneve dhe elektroneve dhe forcat bashkëvepruese



Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan

Sikur në eksperimentin numër 6 ku mbulimi i poleve magnetike me elementin e hekurit (Fe) shkakton rritjen e intensitetit të fushës magnetike brenda cilindrit magnetik dhe pllakave të hekurit (Fe), ashtu edhe këtu paraqitet i njëjti fenomen. Në momentin kur kuartet negative (-2/3 d) tërhiqen dhe vendosen mbi polet e bërthamës negative të elektronit e cila formohet gjatë përzjerjes së kuarteve brenda cilindrit (1/3 u) dhe (-2/3d) rritet shumë energjia e ngarkesës elektrike negative në bërthamën e elektronit (shih figurën 47).

Në këtë rast, kjo rritje e energjisë negative nga bërthama e elektronit duhet të kaloj përtej shtresës së kuarteve negative (-2/3 d) dhe të shpërndahen, ngjashëm sikur që shpërndahet fusha magnetike e cila buron nga trupat qiellorë. Në këtë mënyrë, një pjesë e ngarkesës elektrike negative arrijn të kalojë përtej kësaj shtrese të kuarteve (-2/3 d) dhe ka vlerë elektrike negative $e = -1,6 \times 10^{-19} C$.

Nga kjo ngarkesë elektrike negative që buron nga mbulesa e kuarteve negative formohet fusha elektrostatake negative e elektronit ((-E_N) ?) e cila fushë ka kahje të njëjtë drejtim të njëjtë me vijat e fushës që burojnë nga bërthama e elektronit.

Kurse pjesa e tjetër e vijave të ngarkesës negative nga bërthama e elektronit për shkak të rritjes së intensitetit të ngarkesës elektrike negative nuk mund ta kalojnë shtresën lidike të kuarteve negative (-2/3 d) dhe do të shpërthejnë nga anët anësore të përzjerjes së kuarteve, ashtu sikur buron fusha antimagnetike te trupat qiellorë.

Këto vija të ngarkesës negative që burojnë nga anët anësore formojnë fushën antielektrostatake negative të elektronit -((-E_N) ?), e cila ka intensitet të ndryshëm, drejtim të njëjtë dhe kahje të kundërt me fushën elektrostatake negative ((-E_N) ?). Fusha antielektrostatake negative e elektronit -((-E_N) ?) edhe pse buron nga një ngarkesë negative, i ka të gjitha vetitë e fushës elektrostatake pozitive të protonit.

Sepse nëse llogaritet në formë matematikore, dy shenja me simbole të njëjta negative na japin simbolin pozitiv -((-E_N)

?)= ((+E_N) ?) prandaj ((+E_N) ?) është antifusha pozitive e elektronit, e cila buron në të njëjtën mënyrë ashtu sikur buron fusha antielektrostatake e protonit.

Përfundim

Siç shihet nga e njëjta ngarkesë negative e elektronit njëkohësisht burojnë dy fusha (shih figurën 48). Fusha elektrostatake e elektronit ((-E_E) ?) dhe antifusha elektrostatake e elektronit -((-E_E) ?)=(+EE).

Kështu që elektroni si një ngarkesë negative merr këtë formë (shih figurën 49).

Fusha antielektrostatake e elektronit ((-E_E) ?) edhe pse buron nga një ngarkesë e ngarkuar negative, ajo mund të konsiderohet si një fushë elektrostatake pozitive ngjashëm sikur fusha elektrostatake e protonit ((+E_P) ?).

Siç shihet antifusha elektrostatake e elektronit ((-E_E) ?)ka ngarkesë të njëjtë elektrike sikur fusha elektrostatake e protonit ((+E_P) ?).

Të dyja këto fusha kanë intensitete të ndryshme, drejtime të njëjta dhe kahje të ndryshme.

Konkludim

Fusha antielektrostatake e elektronit ((-E_E) ?) është e vetmja dhe e vetmja forcë që i kundërvihet forcës tërheqëse ndërmjet protonit dhe elektronit. Kjo fushë e pazbuluar dhe e padiktueshme e parandalon goditjen e drejtpërdrejtë të elektronit dhe protonit.

Ngjashmëria ndërmjet protoneve dhe elektroneve

Absolutisht nuk ka asnjë ndryshim ndërmjet mënyrës se si janë formuar protonet dhe elektronet, e vetmja gjë që i bënë të dallojnë janë ngarkesat elektrike si dhe koha e formimit të tyre, që i bie se elektronet janë formuar me një proces më të ngadalshëm ashtu sikurse është formuar Hëna në raport me tokën.

Forcat e bashkëveprimit ndërmjet bërthamës së atomit dhe elektroneve

Edhe pse bërthama e atomit përbëhet nga protonet dhe neutronet, prapë se prapë po nga kjo bërthamë burojnë njëkohësisht dy fusha: e para është fusha elektrostatake e protonit dhe e dyta fusha antielektrostatake e protonit, këto dy fusha njëkohësisht veprojnë mbi elektronin që është i ngarkuar negativisht.

Në këtë rast, fusha elektrostatake pozitive e protonit ((+E_P) ?) e tërheq elektronin rreth vetes, por kësaj tërheqjeje i kundërvihet fusha antielektrostatake e protonit ((-E_P) ?) si fushë elektrostatake negative.

Nga ana e tjetër, pasi edhe nga elektroni burojnë njëkohësisht



Fig47




Fig48

Fusha elektrostatake e elektronit $(-E_e)$
Fusha anti-eklektrostatake e elektronit $-(-E_e) = (+E_e)$




Fig49




Fig 50




Fig51

dy fusha, siç janë fusha elektrostatake negative ((-E_E) ?) dhe fusha antielektrostatake e elektronit

-((-E_E) ?)=(+EE) e cila e ka të njëjtën natyrë sikur te fusha elektrostatake pozitive protonit që i bie se kemi një bashkëveprim të katër fushave.

Atomi i hidrogjenit

Si shembull më të thjeshtë do ta marrim bashkëveprimin e fushave te atomi i Hidrogjenit i cili në përbërjen e tij e ka një proton dhe një elektron që rrotullohet rreth tij. Në këto raste, vetëm te atomi i hidrogjenit, në të njëjtën kohë veprojnë katër

fusha, prej nga, dy fusha elektrostatake burojnë nga protoni në drejtim të elektronit dhe dy fusha burojnë nga elektroni në drejtim të protonit.

E kuptohet nëse ngacmohen elementet e rënda sa që kemi bashkëveprim të qindra fushave elektrostatake dhe antielektrostatake.

Forcat e veprimit nga protoni në drejtim të elektronit

Kemi forcë tërheqëse ndërmjet fushës elektrostatake pozitive të protonit ((+E_P) ?). me fushën elektrostatake negative të elektronit ((-E_E) ?) dhe forcë shtytëse ndërmjet fushës elek-

trostatike pozitive të protonit ((+E_P) ?) me fushën antielektrostatake pozitive të elektronit -((-E_E) ?)=(+EE), shih figurën 50.

Forcat e veprimit nga elektroni në drejtim të protonit

Kemi forcë tërheqëse ndërmjet fushës elektrostatake negative të elektronit ((-E_E) ?) me fushën elektrostatake pozitive të protonit ((+E_P) ?) dhe forcë shtytëse në mes fushës antielektrostatake pozitive të elektronit -((-E_E) ?)=(+EE) dhe forcë shtytëse ndërmjet fushës elektrostatake negative të elektronit ((-E_E) ?) me fushën antielektrostatake negative të protonit ((-E_P) ?), shih figurën 51.

Për këtë arsye, orbita e rrotullimit të elektroneve rreth bërthamës së atomeve është kaotike.

Stabiliteti i bërthamës së atomit

Një atom i hidrogjenit mund të jetë më stabil, sepse ka një proton dhe një elektron, po ta marrim atomin e hekurit (Fe) i cili posedon 26 protone 30 neutrone dhe 26 elektrone, atëherë kemi bashkëveprime të 104 fushave elektrostatake dhe antielektrostatake prej nga kuptohet se sa fusha janë te elementet e rënda që kalojnë qindra fusha që bashkëveprojnë njëkohësisht ndërmjet vete.

Rrotullimi i protoneve rreth elektroneve

Bazuar në trupat e sistemit tonë diellor ku rreth Diellit rrotullohen të gjitha planetët, siç janë: Merkur, Venera, Toka, Marsi, Jupiteri, Saturni, Urani, Neptuni dhe Plutoni. Nga ana e tjetër, ndërmjet këtyre trupave qiellorë duke filluar nga Toka e vazhduar me Jupiterin, Saturnin, Uranin, Neptunin dhe Plutonin përveç asaj që rrotullohen rreth Diellit, në të njëjtën kohë rreth po këtyre trupave rrotullohen edhe shumë satelitë natyralë.

Dihet se strukturat e brendshme të këtyre trupave qiellorë janë plotësisht identike dhe nuk kanë asnjë ndryshim ndërmjet vete, por gjithashtu nuk kanë asnjë ndryshim nga struktura e brendshme e Diellit, si dhe të gjithë këta trupa posedojnë fusha magnetike dhe antifusha magnetike. Prandaj po të bëhet një analizë e hollësishtme, del se një trup qiellor me të njëjtat veti rrotullohet rreth një trupi qiellor me të njëjtat veti.

Duke u bazuar në këtë argument mund të themi se nuk është vetëm elektroni që rrotullohet rreth bërthamës së atomit, por mund të ndodhë që rreth elektronit të rrotullohen neutrone të ngarkuara pozitivisht, sepse dy fushat elektrostatake dhe antielektrostatake që burojnë nga elektroni nuk do ta lejojnë protonin ta godasë elektronin, sado i vogël që të jetë protoni. **Vijon.**

Putini: Rusia e gatshme të luftojë çdo agresor

MOSKË, 28 KORRIK - Presidenti rus Vladimir Putin tha se Marina ruse është e gatshme të luftojë "çdo agresor". Këto komente ai i bëri teksa mori pjesë në paradën e forcave detare në Shën Petersburg. Presidenti Putin nga bordi i një anijeje, në shënimin e Ditës së Marinës në Rusi, tha se kjo ditë

nderon "të gjithë ata që në kohë të ndryshme të historisë i kanë shërbyer Rusisë me nder dhe besnikëri dhe vazhdojnë ta bëjnë një gjë të tillë në këta kufij, por edhe larg atdheut".

Parada detare u mbajt në lumin Neva. Në paradë u përfshinë 43 luftanije dhe nëndetëse, 41 avionë dhe rreth 4 000 trupa.

Parada të tilla janë mbajtur edhe në qytete të tjera të Rusisë, por edhe në portin Tartus në Siri dhe në Sevastopol të Gadishullit të Krimesë, të cilin Rusia e aneksoi nga Ukraina më 2014. Putini po e kalon fundjavën jashtë Moskës, ku mbi 1 300 persona u arrestuan më 27 korrik gjatë një proteste të opozitës.



Situatë e tensionuar në Iran

Situata është mjaft e tensionuar, pasi Irani po mban qëndrim gjithnjë e më agresiv në Gjirin e Hormuzit, një korridor i rëndësishëm global i transportit detar

TEHERAN, 28 KORRIK - Irani e ka cilësuar armiqësor dhe provokues propozimin evropian për të krijuar një flotilje që shoqëron cisternat e naftës në Gjirin e Hormuzit. Autoritetet iraniane shprehen se një masë e tillë do ta shkallëzojë më tej situatën tashmë të tensionuar në Gjirin Persik. Situata është mjaft e ngarkuar, pasi Irani po mban një qëndrim gjithnjë e më agresiv në Gjirin e Hormuzit, një korridor i rëndësishëm global i transportit detar. Pasi forca speciale iraniane këtë muaj morën nën kontroll një cisternë që lundronte nën flamurin britanik, Londra reagoi duke bërë thirrje për bashkëpunim mes evropianëve për t'i mbrojtur mjetet e lundrimit. Edhe Shtetet e Bashkuara kanë propozuar masa

të ngjashme gjatë javëve të fundit. Qëndrimet armiqësore të autoriteteve në Teheran kanë nxitur reagime edhe të komuniteteve emigrante iraniane. Të shtunën një grup aktivistësh ishin mbledhur në Londër me thirrjet për masa më të forta ndëshkuese ndaj Teheranit.

Një grup iranianësh që jetojnë në Britani u tubuan në qendër të Londrës të shtunën me thirrjet për sanksione më të rrepta ndaj Iranit. "Një ndarje reale e fesë nga shteti, një republikë reale demokratike që respekton të drejtat e barabarta të grave, gjinitë dhe të drejtat fetare dhe etnike të pakicave në të gjithë vendin. Duam ta shohim dhënien fund të terrorizmit, të armëve bërthamore, nga regjimi

më brutal dhe shtypës, e veçanërisht nga roja revolucionare e atij vendi", tha Dowlat Nowrouzi, përfaqësues e Këshillit Kombëtar të Rezistencës Iraniane.

Përmes një deklarate grupi iranian i kërkoi qeverisë britanike që ta cilësojë Rojën Revolucionare Iraniane, Ministrinë Iraniane të Zbulimit dhe udhëheqësin suprem Ali Khamenei si subjekte terroriste. "Po mbështes jo vetëm

votuesit e mi, por po shfrytëzoj këtë mundësi për të dërguar një mesazh për kryeministrin tonë të ri se, ajo që po ndodh në Iran dhe sjellja e regjimit të atij vendi nuk është në interes të Mbretërisë së Bashkuar, nuk është në interes të popullit iranian dhe nuk është në interes të rendit botëror. Besoj se tani është koha për të vepruar", tha Matthew Offord, ligjvënës konservator britanik.

Tensionet janë shtuar ndërsa

Irani është bërë gjithnjë e më agresiv në Ngushticën e Hormuzit, një korridor i rëndësishëm për transportin global detar që kalon pranë ujërave territoriale të Iranit.

Në fillim të muajit njësi të Rojës Revolucionare Iraniane përdorën helikopterë dhe anije të vogla për të marrë nën kontroll një anije cisternë që lundronte nën flamurin britanik në Ngushticën e Hormuzit.



ShBA dhe Izraeli testojnë me sukses sistemin e ri të raketave mbrojtëse

TEL-AVIV, 28 KORRIK - Zyrtarët amerikanë dhe ata izraelitë njoftuan kryerjen me sukses të testimit në Alaska të një sistemi të ri mbrojtës me raketa. Sistemi izraelito-amerikan "Arrow 3" u prodhua bashkërisht nga të dyja vendet dhe synon t'i interceptojë raketat e lëshuara mbi atmosferën e Tokës. Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu tha të dielën se testimi i suksesshëm i sistemit të mbrojtjes me raketa "Arrow-3" i tejkaloi të gjitha pritshmëritë.

"Testimi i sistemit 'Arrow 3' arriti me sukses të plotë interceptimin e raketave balistike jashtë atmosferës, në lartësi dhe me shpejtësi që nuk i njihim deri më tani.

Ekzekutimi ishte perfekt dhe secila rakete e goditi objektivin e saj. Nga sot, Izraeli ka aftësinë të veprojë kundër raketave balistike të lëshuara drejt nesh nga Irani apo çdo vend tjetër. Kjo është një arritje e madhe për sigurinë e Izraelit. Të gjithë armiqtë tanë duhet ta dinë se do t'i mundim, si në mbrojtje ashtu edhe në sulm", deklaroi kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu. Ambasadori i ShBA-së në Izrael, David Friedman, tha se administrata Trump ishte e kënaqur me rezultatet dhe shtoi se sistemi "Arrow 3" do të shërbejë si një element kyç i mbrojtjes me raketa të Izraelit.

"Rezultatet ishin të jashtëzakon-



shme. Jemi shumë krenarë për partneritetin tonë me shtetin e Izraelit, si dhe që mundësuam financimin, ekspertizën teknike dhe ofruam hapësirën tonë ajrore

në Alaskë për të zhvilluar këtë testim. Ky është një shembull i jashtëzakonshëm dhe i paprecedent i bashkëpunimit mes dy vendeve tona të mrekullueshme, të

cilin mund ta zgjerojmë më tej, me synimin për ta bërë botën një vend më të sigurtë", tha Ambasadori Friedman.

Sistemi "Arrow 3" është pjesë e një rrjeti kompleks izraelit të mbrojtjes me raketa, ku përfshihet edhe "Iron Dome" (Kubeja e Hekurt), e cila intercepton raketat me rreze të shkurtër, apo "David's Sling" (Llastiqet e Davidit) që godet raketat me rreze të mesme.

Izraeli zhvilloi sistemin "Arrow 3" (Shigjeta 3) për interceptimin e raketave me rreze të gjatë, me ndihmën e kompanisë amerikane të prodhimit të avionëve Boeing. Sistemi u instalua për herë të parë në vitin 2017.

Policia hedh gaz lotsjellës ndaj protestuesve në Hong Kong

HONG-KONG, 28 KORRIK - Në Hong Kong për të dytën ditë me radhë ka pasur përleshje të dhunshme ndërmjet policisë dhe protestuesve prodemokracisë.

Policia përdori gaz lotsjellës ndaj protestuesve, të cilët dolën në rrugët e Hong Kongut, pavarësisht se policia kishte ndaluar mbajtjen e protestës.

Dhjetëra-mija protestues dolën në rrugët në afërsi të zyrës së Qeverisë kineze dhe rrugëve kryesore të Hong Kongut, duke kundërshtuar një projektligj kundërshtues të ekstradimit.

Autoritetet u kanë dhënë leje protestuesve që të protestojnë në një park, por i kanë paralajmëruar që të mos protestojnë jashtë parkut Chater.

Më 27 korrik policia përdori gaz lotsjellës dhe plumba gome për t'i shpërndarë protestuesit në Hong Kong.

Për javë të tëra në Hong Kong qytetarët kanë kundërshtuar një projektligj të ekstradimit. Protestat janë përcjellë me përplasje të dhunshme ndërmjet policisë dhe protestuesve.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E rrallë

Karkalecat pushtojnë Los Anxhelosin

Los Anxhelosi është pushtuar nga karkalecat. Insektet që kanë trembur vendës e turistë kanë vërshuar masivisht nëpër qytet gjatë migrimit të tyre drejt veriut. Sipas ekspertëve, gjendja mund të vazhdojë të paraqitet e tillë për javë të tëra. Tufat e karkalecave kanë qenë aq të mëdha në disa raste, sa autoritetet janë detyruar t'i paralajmërojnë drejtuesit e automjeteve për ulje të shikueshmërisë në rrugë. Specialistët mendojnë se popullata e



karkalecave mund të ketë marrë hov nga pranvera e lagësht, me një nivel më të lartë reshesh shiu se zakonisht.

FOTO E DITES




Të nxehtit që ka kapluar Evropën ka bërë që një ari polar të hedhet në ujë për t'u freskuar në kopshtin zoologjik në Gelsenkirchen të Gjermanisë. /AP/

E jashtëzakonshme

Pensionisti zbulon me detektor metalik dy kilogramë ari

Një pensionist në Australi ka zbuluar dy kilogramë ari, me vlerë rreth 130 000 dollarë në periferi të qytetit Ballarat të rrënuar ari. Prospekti amator po kërkonte nëpër kullotat e vjetra në një zonë që për momentin konsiderohet 'sekret i lartë' kur detektori metalik filloi të binte. Ai filloi të gërmojë dhe shpejt zbuloi një gëzhjojë plumbi. Duke menduar se ishte kjo, ai



ishte gati të ikte, por detektori i tij ishte "këmbëngulës". Kishte diçka tjetër më poshtë. E vendosur nën 30 centimetra thellësi, ai gjeti grumbullin e arit, i cili fillimisht nuk po u besonte syve.

BARSOLETA E DITËS



Gjakovari: Mirëdita zotëri, sa kushton kremi kundër mushkonjave? Shitësi: 20 euro. Gjakovari: Jo, lëre, më mirë po kruhem vetë.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Nga dita e diele ne ora 14:00 dhe 18:00 "Spider-Man Far From Home" 3D,

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 09 min
Rolet: Tom Holland, Samuel L. Jackson, Zendaya, Cobie Smulders, Jon Favreau, JB Smoove, Jacob Batalon, Martin Starr, Marisa Tomei, Jake Gyllenhaal

Regjia: Jon Watts




Nga dita e diele ne ora 22:00 "STUBER"

Aksion/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: Kumail Nanjiani, Dave Bautista, Iko Uwais, Natalie Morales, Betty Gilpin, Jimmy Tatro, with Mira Sorvino, and Karen Gillan

Regjia: Michael Dowse



Në ora 20:00

"THE LION KING" 3D

Aventurë/Dramë; 1 orë 58 min

Rolet: Donald Glover, Seth Rogen, Chiwetel Ejiofor, Beyonce Knowles-Carter, James Earl Jones, Alfre Woodard, John Oliver

Regjia: Jon Favreau




Nga dt. 08.08.2019

"THE ANGRY BIRDS MOVIE 2"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj

Regjia: Thurop Van Orman



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Në familje po prisni një zhvillim të rëndësishëm. Jeni të mbërthyer nga një ankth i pashpjegueshëm.</p>	 <p>DEMI Këto ditë keni vendosur ta ndryshoni pritshmërinë për një projekt të nisur. Mos prisni shumë që të mos zhgënjeheni më pas.</p>	 <p>BINJAKËT Partneri ju ka shprehur një shqetësim që për momentin mund të zgjidhet. Mos e lini pas dore.</p>	 <p>GAFORRJA Keni filluar të kërkoni në të kaluarën tuaj për fakte dhe persona që ju interesojnë për momentin.</p>	 <p>LUANI Keni një karrierë të suksesshme që po mundoheni ta shfrytëzoni edhe për përfitime financiare. Në këtë fushë duhet të prisni pak më shumë.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Në shumë çaste mund të ndiheni keq dhe kjo do t'ju bëjë të thoni gjëra për të cilat do të pendoheni më pas.</p>
 <p>PESHORJA Edhe pse sot do të ketë shumë situata negative ju nuk do të lejoni në asnjë çast t'jua prishin ditën dhe qetësinë tuaj.</p>	 <p>AKREPI Sot duhet të jeni më tolerant me të tjerët. Një fjalë e thënë më tepër mund të shkaktojë konflikt me një mik të mirë.</p>	 <p>SHIGJETARI Emocionalisht ndiheni të përbushur dhe kjo gjë ju sjell në humor. Nuk do të vëreni disa probleme të vogla gjatë ditës.</p>	 <p>BRICJAPI Dikush ka nxjerrë anën më të keqe tuajën sot. Për këtë arsye do të jeni mjaft të ashpër edhe me persona që nuk e meritojnë.</p>	 <p>UJORI Nëse ka ardhur koha të zbuloni një sekret merrni më parë miratimin e personave që kanë lidhje me të.</p>	 <p>PESHQIT Çdo gjë që keni vendosur të bëni sot do të jetë pikërisht siç e kishit menduar. Edhe pse ngurroni, dikush do t'ju mbështesë.</p>

Rita Ora nis pushimet me prindërit në Malibu



Këngëtarja me origjinë shqiptare e me famë ndërkombëtare, Rita Ora, ka nisur pushimet. Rita ka vendosur që bashkë me prindërit e saj, Verën dhe Besnikun, të shkojë në

Malibu për të kaluar disa ditë të mira pushimi. Familja Sahatçiu nga fotografitë që kanë publikuar Rita në "Instagram" duket se po kalon shumë mirë në këtë vend të ngrohtë.

Sophie dhe Joe në zi



Joe Jonas dhe Sophie Turner po mbajnë zi për humbjen e qenit të tyre të dashur, Waldo. Qeni ishte me shëtitësen e tij kur pësoi një aksident. Çifti raportoi incidentin në polici sepse ata ishin aq të mërzhitur saqë duhej të takoheshin me terapistin e tyre. Joe dhe Sophie morën Waldon në prill të vitit të kaluar.



Si nisi lidhja e Dua Lipës me Anwar Hadid?

Dua Lipa dhe vëllai i motrave Hadid, Anwar, janë kthyer në personazhet më të komentuar të shoubizit në mbarë botën, të cilët prej disa javësh po shijojnë romancën e tyre të re. Pas ndarjes nga Isaac, Dua u pa në shoqërinë e 20-vjeçarit dhe në fotografitë që qarkulluan në rrjetet sociale, çifti shfaqej në çaste intime teksa shkëmbejnë puthje në buzë. Megjithëse shumica e ndjekësve ishin kundër kësaj marrëdhënie, duke u shprehur se Dua Lipa

shkonte më shumë si çift me Isaac Carew, duket se këngëtarja as që ka ndërmend t'ua vërë veshin këtyre fjalëve. Anwar kishte deklaruar më parë se ishte fans i Duas dhe një gjë të tillë e kishte bërë edhe këngëtarja, pasi Anwar bën muzikën e tij, raporton "TMZ". Mirëpo, Anwar nisi ta marrë situatën në dorë në muajin qershor kur mësoi se Dua nuk ishte më në një lidhje me Isaac. Ai e bindi këngëtarën për një takim dhe kështu nisi të rrjedhin gjërat mes tyre.

Miley Cyrus nuk do të jetë pjesë e 'MTV Music Awards'



Këngëtarja Miley Cyrus ka thënë se nuk do të performojë në "MTV Music Awards". Ajo ka treguar dhe arsyen duke qenë mjaft e sqartë me ndjekësit e saj. Cyrus nuk do të marrë pjesë pasi nuk është nominuar për të qenë fituese dhe

diçka e tillë e ka ofenduar. Më pas një postim i një fanse, e cila shprehej se nuk do ta shihte MTV nëse Miley nuk do të ishte pjesë, u ka dhënë fund dyshimeve. Në po të njëjtin postim është përgjigjur vetë këngëtarja duke shkruar: "Sigurisht se jo".

DITËLINDJA E ADEM DEMAÇIT DUHET TË SHPALLET FESTË KOMBËTARE NË KOSOVË

Gjekë GJONLEKAJ
/Nju Jork /

Zonja dhe zotërinj,
Jemi mbledhur sot këtu në Royal Regency Hotel në Nju Jork për ta nderuar legjendën e racës arbërore, Adem Demaçin, i cili u nda nga kjo jetë më 26 korrik 2018. Pas lirimit nga burgu u prit me nderimet më të mëdha në Kosovë. Dhjetëra mijëra shqiptarë shkuan për t'i dhënë dorën këtij profeti. Adem Demaçi u largua nga kjo jetë në jubileun e disa datave historike të popullit shqiptar. Sivjet kujtojmë 550-vjetorin e vdekjes së Gjergj Kastriot Skënderbeut, 140-vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, 110-vjetorin e Kongresit të Manastirit dhe 10-vjetorin e pavarësisë së Kosovës. Adem Demaçi ishte i lidhur shpirtërisht me të gjitha këto data historike, por dita më e lumtur e jetës së tij kishte qenë 17 shkurti i vitit 2008. Pas shumë vuajtjesh e mundimesh më në fund arriti ta shohë Kosovën e tij të dashur të lirë dhe të pavarur. Vlen për ta shënuar se sivjet është 82-vjetori i lindjes së Ismail Kadaresë, është gjithashtu 82-vjetori i lindjes së Rexhep Qosjes dhe 82-vjetori i lindjes së Adem Demaçit. Ky trashë i famshëm kishte lindur në vitin 1936. Krijimtaria e tyre letrare pasuron dhe nderon kombin shqiptar brenda dhe jashtë atdheut. Të gjitha këto data historike kishin qenë frymëzim për Adem Demaçin, ndërsa liria dhe pavarësia e Kosovës ishin pjesa më e dhimbshme dhe më e lumtur e jetës së tij. Për Kosovën e tij të dashur kishte përjetuar ditët e kryqëzimit. "Kalvarin e Kosovës" Adem Demaçi e kishte përjetuar më rëndë se asnjë shqiptar tjetër. Të gjitha këto data janë të rrafshit kombëtar. Por ky ishte idealist i rrafshit ndërkombëtar. Adem Demaçi veçoi paralelisht me personalitetet më të njohura të botës në fushëbetë të lirisë dhe të drejtave të njeriut. Sivjet është 50-vjetori i rënies tragjike të Martin Luther King Jr. Martini i Amerikës dhe Ademi i Kosovës kishin shumë karakteristika të njëjta. Martin Luther King Jr. ishte trim siç ishte edhe Adem Demaçi, pastaj ishte orator siç ishte edhe

Ademi. Martin Luther King Jr. ishte i pakorrupsionshëm, i tillë ishte edhe Adem Demaçi. Martin Luther King Jr. është personaliteti më i nderuar i Shteteve të Bashkuara. Ditëlindja e tij dhe ditëlindja e Jezu Krishtit janë festat kombëtare dhe asnjë personalitet tjetër i historisë amerikane nuk e gëzon këtë nderim. Disa historianë të kombit dhe të fesë e quajnë Martin Luther profet. Ai ka thënë: "Ata që kanë frikë vdekjen nuk e fitojnë lirinë". Nga historia e kombit tonë kisha mësuar se Gjergj Kastriot Skënderbeu nuk kishte frikë vdekjen dhe sukseset e tij ishin rezultatet e trimërisë së tij. Unë personalisht kam takuar një shqiptarë që nuk kishte frikë vdekjen. Ajo ishte Nëna Terezë. Më vonë takova edhe një shqiptar tjetër që nuk kishte frikë vdekjen. Ai ishte Adem Demaçi. Nëna Terezë e adhuronte jetën ashtu siç e adhuronte edhe Adem Demaçi. Ai mund të fliste gjithë ditën për shëndetin, për ushqimet e shëndetshme për rëndësinë e gjimnastikës dhe ushtrimeve të tjera fizike. Dukej si të ishte profesor i mjekësisë. Asnjë ditë në jetën e tij nuk u ndalua pa thënë të vërtetën për Kosovën.

Ai fliste vazhdimisht kundër korrupsioneve të ndryshme. Gjatë një bisede telefonike e pyeta nëse kishte frikë ndërkombëtarët sepse ata mund ta burgosnin për deklaratat e tij tepër të ashpra. Ai tha: "Do të isha me fat sikur të më burgosnin. Burgimi im nga ndërkombëtarët do të zgjonte kurajën e gazetarëve të huaj rreth problemeve të Kosovës" Një herë tjetër e pyeta për kushtet e jetesës dhe për të ardhurat mujore. Ai tha se pensioni i tij ishte 100 marka në muaj. Po kjo sasi është tepër e vogël për ju zotni Demaçi. Nuk është problem, është në rregull, ngase është njësoj si rroga e shumicës së qytetarëve të këtij vendi. Unë nuk dua më shumë. Jam i kënaqur me kaq tha Demaçi, e u kishte bërë shumë vërejtje ndërkombëtarëve sidomos për korrupsion. Ai thoshte që politikanët e Kosovës janë të korruptuar dhe si pasojë ata nuk mund të veprojnë për të mirën e Kosovës. Këtë qëndrim e ilustronte me themelimin e Gjykatës Speciale të Hagës për Kosovën. Ai thoshte që edhe luftëtarët e lirisë ishin korruptuar aq shumë sa që nuk kishin forcë morale dhe as politike të

kundërshtojnë themelimin e kësaj Gjykate të mbrapshtë. Ato ditë iu luta t'i jepte një intervistë "Zërit të Amerikës". E pranoi me gjithë dëshirë, bile tha shumë gjëra në atë intervistë. Këta ishin luftëtarë të lirisë dhe deri që u bënë miq me ju nuk ishin të korruptuar. Të gjitha akuzat e ilustronte me fakte, siç kishte ndodhur me falimentimin e bankës gjermane dhe fondet e pensionistëve të Kosovës. Sivjet është 100-vjetori i lindjes së Nelson Mandelës, që ishte njëri prej disidentëve më të njohur të botës. Nelson Mandela është shpërblyer me Çmimin Nobel siç është shpërblyer edhe Martin Luther King Jr. Mandela dhe Martin Luther King gjatë kohës së mundimeve kishin mbështetje të madhe kombëtare dhe ndërkombëtare. Nelson Mandela kishte përkrahjen morale të 40 e sa vendeve afrikane, ku jetojnë 500 milionë afrikanë. Ndërsa Adem Demaçi ishte qyq vetëm. Ata u shpërblyen me Çmimin Nobel por jo Adem Demaçi, pavarësisht se e meritonte njësoj si ata. Por ky është fati i popujve të vegjël. Nelson Mandela u pasurua shumë pas ardhjes së tij në pushtet. Bile ai u akuzua për korrupsion. Në paradën që ishte organizuar për nder të tij në Nju Jork, Mandela përshëndeti njerëzit me atë grushtin e "famshëm" komunist, sepse miqtë e tij në burg kishin qënë regjimet komuniste në krye me Fidel Kastron. Ajo paradë kalonte përpara zyrës së VOA në Federal Plaza, bile dola në rrugë për ta parë dhe bëra një reportazh për atë ceremoni. Për çudi Nelson Mandela ishte në anën e Millosheviqit gjatë Luftës së Kosovës. Të mos harrojmë se edhe Ivo Andriqi ishte nobelist. Leonard Fox, ish-profesor i Universitetit Columbia në Nju Jork, ka thënë se Adem Demaçi ishte disidenti më i pa korruptuar në botë. Për shqiptarët e Amerikës Adem Demaçi ishte simbol i lirisë së Kosovës. Në gjitha demonstratat tona e mbanim në duar portretin e tij që shkruante: "Free Kosova, Free Adem Demaçi" (Lironi Kosovën, Lironi Adem Demaçin). Organizata për të Drejtat e Njeriut dhe Human Rights Watch dhe Amnesty

International ishin shumë të brengosura për gjendjen e tij shëndetësore në burg, ata kishin frikë se ai mund të verbohej ngase tërë kohën e kalonte në terr. Gazetarët e huaj e kishin vizituar në burgun e Sremska Mitrovicës. Adem Demaçi vuante dyfish, sepse kishte bërë thirrje dhe veprime për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Ai ishte armik i sovranitetit dhe integritetit të Jugosllavisë. Pastaj ishte armik i diktaturës komuniste jugosllave. Kolegjet e tij në burgjet jugosllave ishin atje sepse kishin kritikuar regjimin. Të tillë kishin qenë Mihaillovi e Gjillasi. Adem Demaçi kishte qëndruar për një kohë të gjatë në burgun e Sremska Mitrovicës ku kishte qenë edhe shkrimtari dhe disidenti i njohur Millovan Gjillas. Demaçi dhe Gjillasi ishin përplasur shumë herë kundër njëri tjetrit rreth problemeve shqiptare në Jugosllavi. Adem Demaçi tregonte se Millovan Gjillas ishte nacionalist. Emëri i djalit të Adem Demaçit është Shqiptar Demaçi, ndërsa emri i bijës së tij është Abetare Demaçi. Unë kurrë në jetën time nuk kam takuar shqiptar me emrin Shqiptar. Shqiptari në këtë rast personifikon kombin. Abetarja arsimin. Kombi dhe arsimit janë alfa dhe omega. Ata u shkolluan në kushte tepër të vështira. Megjthatë Shqiptari është mjek dhe kirurg i njohur në Prishtinë, ndërsa Abetarja elektro-inxhinere në Londër. Të dy janë të martuar dhe kanë fëmijë. Për shkollimin e tyre të vështirë tregon Hysen Ulaj. Ai kishte qenë në kohën e tyre student në Universitetin e Prishtinës. Zoti Ulaj tregon se ata ishin shumë të izoluar, sepse ishin në sy të pushtetit. Për arsimimin e tyre të shkëlqyeshëm dhe edukatën e mrekullueshme merita kryesore i takon nënës së tyre Xhemajlie Hoxha Demaçi. Ajo ishte bashkëshorte e vërtetë dhe nënë e shkëlqyeshme. Ishte mësuese shumë e përkushtuar. Në mesin e viteve '50-ta Adem Demaçi u bë shkrimtar i njohur sidomos pas botimit të romanit "Gjarpërinjtë e Gjakut". Kjo vepër ishte ndaluar menjëherë pas botimit. Është njëra prej vepërave më të mira të letërsisë





sonë. Thirrja e tij biblike "shtrije dorën e pajtimit e jo dorën e krimin" është mbase fjalë më e bukur e gjuhës shqipe. Kjo është thirrje biblike që do të citohet përgjithmonë. Shumë nga thëniet e tij janë profetike. Në vitin 1991 Parlamenti Evropian e kishte shpërblyer me Çmimin Saharov, që është çmimi më i lartë i këtij lloji pas Çmimit Nobel. Ai ishte ftuar në Strasburg për këtë dhuratë shumë të çmuar. Më këtë rast kishte mbajtur një fjalim para Parlamentit, duke i falënderuar për këtë shpërblim. Kishte folur gjerë e gjatë për historinë e Ballkanit dhe të popullit shqiptar. Adem Demaçi kishte folur gjerësisht për dhunën sllave mbi shqiptarët. Ai ua kishte thënë deputetëve evropianë se vuajtjet dhe mundimet e popullit shqiptar janë pasojë e politikës evropiane, ngase ata i kishin ndarë e copëtuar tokat shqiptare. Adem Demaçi ishte treguar shumë i guximshëm. Kështu kishte folur At. Gjergj Fishta në Konferencën e Paqes në Paris në vitin 1919 dhe Imzot Noli në Gjenevë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në vitin 1924. Fondacioni "Dedë Gjo'Luli" në Nju Jork në mars të vitit 1992 e kishte ftuar për të marrë pjesë në kremtimin e Kryengritjes së Malësisë së Madhe të vitit 1911. Edhe pse në atë kohë gjendej në Suedi, Adem Demaçi mori pjesë shumë i lumtur në festën tonë. Bile bëri pak humor kur tha: "Ju falënderoj ju malësorëve dhe Dedë Gjo'Lulin që më ftuat në këtë

festë". Ai tregonte se gjatë kohës kur kishte qëndruar në burg e kishte dëgjuar shumë herë këngën: "Dedë Gjo'Luli shkruan një letër". Bile kishte thënë një herë se ajo këngë kishte qenë frymëzim për të. Pas disa ditësh organizova një pritje dhe intervistës me gazetarët amerikanë dhe të huaj në studion e madhe të "Zërit të Amerikës" në Nju Jork. Drejtori i VOA-s, Al Banks e priti mirë, bile kur i dha dorën i tha: "Ku ishe zoti Demaçi që të pres tash 30 vjet" (where have you been Mr. Demaçi, I've been waiting for you for 30 years). Gazetarët biseduan me Ademën për më shumë se një orë. Ai u la përshtypje të mrekullueshme. Ai foli gjerësisht për Slllobodan Millosheviqin dhe tragjedinë që do t'u sjellë popujve të Ballkanit, sidomos shqiptarëve, boshnjakëve dhe kroatëve. Intervista e tij u transmetua në të gjitha gjuhët e "Zërit të Amerikës", bile edhe në anglisht. Ata thanë se Adem Demaçi ishte humanist i madh. Disa ditë më vonë u ftua për një konferencë me gazetarët në Kombet e Bashkuara. Këtë takim e organizoi i Ngarkuari me Punë i Shqipërisë në OKB, Sokol Necaj. Një javë më vonë u prit nga Komuniteti Shqiptar. Këtë takim e drejtoi aktivisti Luigj Gjokaj. Ndërsa po fliste për rëndësinë e demokracisë, Dodë Gega përndryshe antikomunist i njohur nga Puka e pyeti. Ju zotni Demaçi dikur

keni folur ndryshe e jo siç po flisni sot. Ademi buzëqeshi, "e di që e di që zotni ku e ke fjalën dhe vazhdoi": "vitin e kaluar isha në Shqipëri e vizitova atë vend fund e maje dhe dua t'ua them të vërtetën e hidhur se as krijesat e marsit nuk kishin dijtë me e shkatërruar Shqipërinë siç e ka shkatërruar Enver Hoxha dhe Partia e tij e Punës". Pas këtyre fjalëve Dodë Gega u ngrit në këmbë i dha dorën dhe u përqaftuan. Të pranishmit u emocionuan. Një javë më vonë Joseph Dio Guardi kishte organizuar takim të rëndësishme në Uashington për Adem Demaçin. Atje u prit nga senatori Robert Dole dhe me disa kongresmenë të njohur. Por takimi më i rëndësishëm kishte qenë me Sekretarin e Shtetit Lawrence Eagleburger. Në këtë takim morën pjesë Mark Krasniqi edhe Elez Biberaj. Adem Demaçi e kishte pyetur sekretarin Eagleburger nëse Shtetet e Bashkuara do ta njohin pavarësinë e Kosovës? Zoti Eagleburger ishte përgjigjur tash për tash jo, por i kishte thënë mos gabë me u thënë shqiptarëve nesër po sepse kam me të demantuar menjëherë. Elezi tregon se ata kishin hyrë për një derë, dhe kishin dalë për një derë tjetër, ngase aty në korridor tek dera kryesore priste ambasadori jugosllav për një takim me zotni Eagleburger. Për këto, dhe episode të tjera mund të tregojë vetëm Elez Biberaj, ngase asnjëri prej tyre nuk jeton më. Më vonë Adem Demaçi kishte shkruar në Detroit për një

vizitë të Komunitetit të Malësisë. Atje kishte shumë miq malësorë dhe siç tregonte ata e kishin prit me nderime të mëdha. Malësorët e Detroitit i kishin dhuruar një sasi të konsiderueshme të hollash që i kishte përdorur për një turne politik në Evropë, në Australi, në Zelandën e Re dhe në Turqi. Kurdoherë kam folur me të në telefon më porosiste t'i falënderoja malësorët për miqësi dhe sjellje bujare. Ai ishte mirënjohës i jashtëzakonshëm. Por njeriu që e ka nderuar më shumë se kushdo tjetër Adem Demaçin në Amerikë është Shaqir Gashi dhe familja e tij. Shtëpia e Shaqir Gashit ishte si shtëpia e tij. Shaqir Gashi i kishte krijuar kushte të shkëlqyeshme për jetesën e Ademit në Nju Jork. Kishte vënë në dispozicion një apartament shumë komod ku mund të takonte shqiptarët dhe amerikanët për vizita të ndryshme. Aty Shaqiri kishte një restorant luksoz. Zonja Gashi kishte jetuar derë më derë me familjen e Adem Demaçit në Prishtinë. Në verën e vitit 2001 gazeta "The New York Times" botoi një artikull të gjatë për Adem Demaçin. Titulli i atij shkrimi ishte "Adem Demaçi Kampion i Lirisë së Kosovës" (Adem Demaçi Champion of Free Kosova). Sipas kësaj gazete Ademi është kampion i lirisë së Kosovës e jo dikush tjetër siç mendojnë disa dallaveraxhi. Adem Demaçi u sha dhe u fye më shumë se asnjë shqiptar tjetër në Kosovë. Ai më

tregonte për ato shpifje të cilat shumë herë e kishin munduar shpirtërisht më shumë se torturat në burgjet jugosllave. Armiqtë e tij kishin përhapur propagandë se ai gjoja kishte jetuar në hotelet më të mira të Jugosllavisë dhe se atje kishte kaluar kohën me gratë dhe vajzat më të bukura dhe më të mbrapshta të qytetit. Adem Demaçi nuk ua fali kurrë ato shpifje. Ata e treguan idiotësinë e tyre edhe në ditën e vdekjes së tij. Adem Demaçi meriton shumë nderime. Meriton ngritjen e një memoriali ashtu siç është Memoriali i Skënderbeut në Krujë, ose Memoriali i Abraham Lincolnit në Uashington. Ai meriton një tempull ku do të luten shqiptarët para këtij burri të madh të kombit. Ai ishte njeriu më humanist që kam parë në jetë, pas Nënës Terezës. Adem Demaçi ka qenë shkrimtar, orator dhe filozof si të kishte qenë i shkollës së Sokratit. Asnjë ditë në jetë nuk bëri kompromise në dëm të çështjes kombëtare. Do të kujtohet gjithmonë biseda e tij telefonike me Sekretaren Amerikane të Shtetit Madeline Albright. Gjatë konferencës së Rambujesë ajo e kishte thirrë Demaçin në telefon, bile e kishte thirrur për tri ditë me rrallë. Zoti Demaçi në atë kohë gjendej në Lubjanë të Sllovenisë. Me në fund pas tri ditësh kishin vendosur lidhje telefonike. Zonja Albright ishte ankuar se kishte prit për tri dite, rreth problemeve të Kosovës. E di zonja e nderuar ishte përgjigjur Demaçi, por të lutem mos u zemëro sepse unë për lirinë e Kosovës kam qëndruar në burgjet Jugosllave 30 vjet. Pas këtij komentit zonja Madeline Albright ishte qetësuar. Ai ishte personalitet i përmasave botërore dhe nuk përkulej përpara asnjë personaliteti në botë. Por ai ishte gjithmonë serioz dhe i sinqertë. Breznitë e ardhshme duhet patjetër të mësojnë nga ky gjigant i kombit tonë. Kishte dhunti profetike të Abrahamit dhe të Moisiut. Ishte si një Promethe i lidhur në shkëmb të Shumadisë. Adem Demaçi është gurthemeli i parë dhe kryesor i lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Unë personalisht mësova shumë nga ky trim legjendar dhe jam krenar që jam i fisit të një trimi kaq të madh. Për artet e ndryshme dhe për historinë Adem Demaçi do të mbetet përgjithmonë burim dhe frymëzim për vepra të mëdha. Kosova duhet ta shpallë ditëlindjen e Adem Demaçit festë kombëtare.

P. s.
Ky fjalim që është mbajtur në gusht të vitit të kaluar në orën përkujtimore për Adem Demaçin në Nju Jork botohet me disa ndryshime të vogla. Një mik imi dhe i Adem Demaçit më sugjeroi që kjo elegji të mbetet e shkruar.

'ZËRI I NËNËS PËRTEJ VARRIT MË BËRI TË KTHEHESHA DJATHTAS, JO MAJTAS KU MË PRISTE VDEKJA E SIGURT'

Autorja Theresa Cheung është në mision për të provuar se ëndrrat mund të parashikojnë të ardhmen dhe se jeta e përtëjme ekziston. E ftuar në programin e mëngjesit "Good Morning Britain", ajo rrëfeu historinë e saj personale dhe punën kërkimore.

"Më kujtohet shumë qartë momenti kur jeta ime ndryshoi përgjithmonë. Po udhëtoja me makinë dhe kisha ndaluar në semafor. Para meje ishte një kamion dhe teksa prisja që semafori të hapet, papritur dëgjova zërin e nënës time që më thoshte të kthehesha djathtas, ndonëse duhet të kthehesha majtas. Nëna ime kishte vdekur nga kanceri vite më parë, por zëri i saj ishte fare i qartë. U trondita, por ishte kaq reale sa bëra atë që më tha".

E teksa kamioni u kthye majtas, një qen i doli përpara, duke bërë që makinat të përplaseshin me njëra-tjetrën. Të gjithë personat që udhëtonin në makinën pas mbetën të vvarë. "Nëse nuk do të kisha dëgjuar nënën time, ajo do të isha unë", tha Cheung.

Pas kësaj ngjarjeje, autorja nisi të mblidhte histori të tjera të njerëzve që kishin pasur eksperiencën të jashtëzakonshme.

Autorja kujton edhe disa prej historive të para që i mbërritën në adresën e saj.

Një vajzë i tregoi eksperiencën e saj pranë vdekjes. Ajo kishte rënë pa ndjenja në spital, ku ndodhej pasi ishte plagosur rëndë. Kuptoi se fryma po largohej nga trupi i saj dhe se do të vdiste. Ajo tha se trupi i saj fizik po përpigë fort që të shtypte butonin e alarmit që të njoftonte mjekët, por nga brenda ndihej e pastër dhe e qetë, përpara se përpara saj të shfaqej një dritë e bardhë. Me qetësi, ajo pa mjekët që vrapuan drejt saj dhe u përpoqën ta sillnin në jetë, por ajo ndihej e lehtë si pupël dhe nuk donte të kthehej në trupin e saj fizik. Por në këtë moment dëgjoi një zë të lartë mashkulli që i tha: "Duhet të kthehesh tani. Koha jote në Tokë nuk ka mbaruar ende dhe ke shumë gjëra për të bërë".

Megjithatë, Cheung nuk e mbështet punën e saj vetëm me histori njerëzore.

Neurokirurgu Eban Alexander ishte i njohur për skepticizmin e tij. Por pas një aksidenti ku vdiq dhe u risoll në jetë, ai raportoi se kishte shkuar në parajsë dhe ishte takuar me një motër të adoptuar, që nuk e



dinte se e kishte. Teksa ia tregoi këtë familjes së tij, u konfirmua se ishte e vërtetë. Kjo i hapi rrugë shumë kërkimeve shkencore për këtë çështje.

Në 2014-n një studim tek 2 mijë pacientë në spitale nëpër gjithë botën, i realizuar nga Dr Sam Parnia, tregoi se ndërgjegjia mund t'i mbijetojë vdekjes së trupit dhe trurit. Kur

zemra ndalon së punuari, qelizat e trurit janë ende aktive disa orë pas vdekjes.

Në 2 mijë pacientë, 40 përqind raportuan se ishin në gjendje të shihnin veten e tyre dhe ishin të ndërgjegjshëm që kishin vdekur. Shumë përshkruajtën një dritë të bardhë të shndritshme, takim me të afërm dhe një ndjenjë të

madhe dashurie.

Cheung thotë se puna dhe librat e saj po tërheqin gjithnjë e më shumë vëmendje, megjithatë ajo shprehet se nuk është e kënaqur. "Jam e dëshpëruar për të ditur më shumë", shton Cheung.

Theresa Cheung është autore i disa librave best seller mbi spiritualizmin.



JA 21 FAKTE TRONDITËSE QË NUK I DINIT PËR MARILYN MONROE



Marilyn Monroe është një ikonë që nuk vdes kurrë, një yll i shndritshëm që ka lënë ende pyetje pa përgjigje. Por, askush nuk e di për 21 fakte tronditëse për “perëndeshën” e bukurisë së Hollywood:

1-Marlyn Monroe kishte një koeficient inteligjence 168, më të lartë se Albert Ajnshtajn.

2-Emri i vërtetë i Marilyn Monroe ishte Norma Jeane Mortenson.

3-Marilyn Monroe ishte brune natyrale dhe i'u nënshtrua operacioneve plastike në mjekër dhe hundë në fillimet e karrierës së saj.

4-Ajo nuk i donte diamantët ashtu siç këndonte për to.

5-Marilyn Monroe i merrej goja.

6-Fustanet e saj kushtojnë shumë sot.

7-Natën e saj të fundit e kaloi në shtëpinë e Frank Sinatra – në kazonë Cal Neva në kompaninë e bosit Sam Giancana.

8-Ajo u pagua vetëm 50 dollarë për fotot nudo.

9-Asaj i pëlqenin Beethoven, Mozart dhe Louis Armstrong.

10-Marilyn pëlqente të gatuate, dhe gatuate shumë mirë!

11- Ella Fitzgerald e ndërtoi karrierën e saj falë Marilyn Monroe.

12-Për 12 vite njerëzit vendosnin lule në varrin e Marilyn Monroe.

13-Monroe konvertoi besimin e saj në judaizëm pasi u martua me dramaturgun Arthur Miller.

14-Ajo donte dëshpërimisht të bëhej nënë.

15- Muzikanti Marilyn Manson e vendosi emrin e tij dhe të grupit të tij nga emrat e Marilyn Monroe dhe Charles Manson për të projektuar një dikotomi midis të mirës dhe të keqes.

16-Frank Sinatra i dhuroi Marilyn një qen maltez për ta mbështetur pas ndarjes me Arthur Miller.

17-Marilyn Monroe nuk u nominua kurrë për një çmim të “Academy Ward”.

18-Shumë njerëz kryen vetëvrasje kur zbuluan për vdekjen e saj.

19-Marilyn Monroe u varros me fustanin e saj të preferuar jeshil Puçi.

20-Ajo shkroi një autobiografi “Historia ime”.

21-Marilyn e kishte të vështirë të memorizonte frazat për rolet e saj në filma.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Ramadani: Sivjet medalja e artë, vitin tjetër kampion ballkanik

16-vjeçari Muhamet Ramadani medaljen e artë të cilën e fitoi në Festivalin Olimpik Evropian për të Rinj (EYOF), "Baku 2019", ia dedikon familjes dhe gjithë Kosovës, kurse synim i tij është të dalë kampion ballkanik në vitin 2020. "Pas medaljes në Baku, synimi im është që vitin tjetër të bëhem kampion i Ballkanit me gjyle të 6 kg", ka thënë Ramadani

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 28 KORRIK - Atleti Muhamet Ramadani të premtën e kaluar ka shkruar historinë e re në sportin e Kosovës, pasi e ka fituar medaljen e artë në disiplinën hedhje e gjyles 5 kilogramë në Festivalin Olimpik Evropian për të Rinj (EYOF), "Baku 2019". 16-vjeçari nga Mitrovica e hodhi gjylen në largësi 19.75 metra, rreth 1 metër më shumë se vendi i dytë, i cili i takoi atletit rus Semen Borodayev. I kontaktuar të dielën nga redaksia e sportit e gazetës "Epoka e re", Muhamet Ramadani ka thënë se rrugëtimi për të fituar medalje të artë në një ngjarje kaq të rëndësishme sportive ka qenë mjaftë i mundshëm, pasi ai së bashku me babanë, njëkohësisht trajnerin e tij, Shaban Ramadani, kanë punuar dy vjet për të arritur këtë sukses të jashtëzakonshëm. "Rrugëtimi ishte tepër i vështirë pasi kemi

punuar gati që dy vjet me babanë tim që të vijë kjo ditë. Jam shumë i lumtur që munda ynë është shpëguar dhe falënderoj babanë tim, Shabanin, që më ka ushtruar dhe përkrahur gjithmonë, po ashtu e falënderoj edhe Klubin Atletik 'Mitrovica' që më ka dhënë kurajë", ka thënë Ramdani.

I pyetur se kujt ia dedikon medaljen e artë, Ramadani është përgjigjur: "Familjes dhe gjithë Kosovës". Atleti i ri më pas ka folur edhe për finalen ku doli triumfues dhe arriti që t'i sjellë Kosovës medalje nga lojërat që u mbajtën në Baku. "Në hedhje të gjyles ishin sportistët më të mirë të Evropës dhe jam krenar që unë arrita të triumfojë. Normalisht se ky sukses më jep edhe më shumë motiv për garat e radhës", ka shtuar ai.

Atleti 16-vjeçar në fund foli edhe për synimet që ka për të ardhmen. Ai synon që t'i sjellë Kosovës medalje edhe nga garat ku do të marrë pjesë. "Pas medaljes në

Baku, synimi im është që vitin tjetër të bëhem kampion i Ballkanit me gjyle të 6 kg", ka thënë Ramadani.

Kosova përfundon e 26-ta në 'Baku 2019', lë pas Serbinë

Ekipi Olimpik i Kosovës ka përfunduar në vendin e 26 nga 50 shtete pjesëmarrëse në Festivalin Olimpik Evropian për të Rinj (EYOF), "Baku 2019". Ky sukses ka ardhur pas medaljes së artë të atletit, Muhamet Ramadani. Ai fitoi të artën në disiplinën hedhje e gjyles. Kosova la pas shtete të fuqishme si Hungaria, e cila fitoi 19 medalje, por jo edhe të artën, Zvicrën, Slloveninë, Serbinë etj. Ekipi i Kosovës u përfaqësua në kryeqytetin e Azerbajxhanit me 18 sportistë të pesë sporteve të ndryshme, ndërsa fitoi një medalje. EYOF-i ardhshëm 2023 do të mbahet në Banska Bistrica të Sllovakisë.

SHKURT

U18-shat pësuan humbje nga Austria

Basketbollistët e Kosovës U18 kanë pësuar humbje nga Austria 79:92, në Kampionatin Evropian, Divizioni B, që po zhvillohet në Rumani. "Dardanët" e rinj e fituan çerekun e parë 23:19 dhe luftuan deri në fund, por pa arritur të fitojnë. Donat Rexhepi kishte 20 pikë e tetë kërcime, derisa u ndihmua nga Albin Berisha me 17 pikë dhe Donat Musa me 16. Me 11 pikë e nëntë kërcime kontribuoi Erhan Sholla.

Bashkimi transferon Zogianin dhe Zyberajn

KF Bashkimi ka arritur marrëveshje për sezonin 2019/20 me dy lojtarë me përvojë të madhe, me dy mjeshtrë të futbollit, Visar Zogianin dhe Erzen Zyberajn. "Visari ka një përvojë të jashtëzakonshme në futbollit kosovar, shqiptar dhe atë francez, i cili jorastësisht quhet mjeshtrë i mesfushës. Visari veshi fanellat e shumicës së skuadrave të njohura të Superligës, derisa sezonin e kaluar ishte truri i skuadrës së KF Dardanës. Gjithashtu, edhe Erzeni ka një bagazh të madh në futbollin kosovar, karakterizohet si një luftëtar i madh dhe shumë punëtor. Edhe Erzeni sezonin e kaluar ishte pjesë e KF Dardanës duke qenë një lojtar i pathyeshëm i mbrojtjes. Mirë se vini në shtëpinë e madhe Visar dhe Erzen. Faleminderit që i besuat projektit të ri të KF Bashkimit", thuhet në njoftimin e KF Bashkimi.

Mustafa 'aterron' në Drenicë

Në vazhden e angazhimeve për krijimin e një skuadre të fortë për edicionin e ardhshëm, KF Drenica ka arritur marrëveshje njëvjeçare me mesfushorin e njohur nga Vushtrria, Argjent Mustafa. 26-vjeçari ka bërë karrierë në shumë skuadra si FC Prishtina, KF Trepça '89, KS Besa Kavajë, KF Laçi, KF Partizani, FC Kamza, KF Vushtrria, kurse ekipi ku u paraqit së fundmi ishte KF Flamurtari (Vlorë).

Ferit Keta për tre raunde e mposhti boksierin serb

Boksierit shqiptar Ferit Keta i janë dashur vetëm tre raunde për ta mposhtur me "konck-out" serbin Slavoljub Mitiq, në duelin e zhvilluar mes të dyve në Maltë. Dueli i Ketës me boksierin serb ishte kryesori në "Summer showdown" në Maltë, duke qenë se ecuria e boksierit shqiptar është e jashtëzakonshme, ku nuk njuh asnjë humbje në peshën "kruizer". Kjo ishte fitorja e 13-të e Ferit Ketës në boks dhe e 110-ta e fituar me "konck-out", shifra mjaft të mira këto për boksierin 30-vjeçar.

Istog transferon Kurteshin

KF Istogu e ka zyrtarizuar transferimin e futbollistit Egzon Kurteshi, i cili ishte pjesë e skuadrës Onix nga Banja. Kurteshi në të kaluarën ka luajtur edhe për KEK-un, Flamurtarin dhe Fushë-Kosovën, derisa pozita e tij është mbrojtës i krahut të djathtë, por edhe mesfushor i djathtë. "Jam i lumtur që nënshkrova kontratë me klubin e Istogut. Projekti i klubit dhe serioziteti i kryesisë së klubit bën që unë të transferohem në Istog. Falënderoj kryesinë e klubit dhe trajnerin Shoshi që besuan shumë në aftësitë e mia. Shpresoj që besimin e tyre t'ia shpëguajë në fushë", ka thënë Kurteshi.

Shoshi humbet parakualifikimet e "Eurobasket 2021"

PRISHTINË, 28 KORRIK - Një nga basketbollistët kryesorë të Kosovës, Lis Shoshi, është lënduar në ndeshjen e parë miqësore ndaj Shqipërisë dhe si pasojë do të mungojë në

takimet parakualifikuese "Eurobasket 2021". Shoshi është lënduar në krahun e djathtë, derisa mjekët kanë konstatuar se ai nuk do të jetë në gjendje të luajë në përballjet me

Luksemburgun dhe Britaninë e Madhe, që zhvillohen nga 3 deri më 21 gusht. Ai do të mungojë në parakualifikime, kurse gjendja e tij do të vlerësohet më tutje sesa do të jetë jashtë parketit.

Shoshi është një mungesë e madhe për Kosovën, duke qenë një nga shtyllat e ekipit. Ai gjatë kësaj vere nënshkroi kontratë me skuadrën e njohur gjermane S. Oliver Würzburg.



Futbollistët kuqezi në udhëkryq për të ardhmen

TIRANË, 28 KORRIK - Shumë prej futbollistëve të Kombëtares së Shqipërisë janë me valixhe në duar. E ardhmja e tyre është në pikëpyetje dhe situata e krijuar mund të ndikojë negativisht edhe në kombëtare. Një nga futbollistët më të lakuar sa i përket të ardhmes është mbrojtësi Elseid Hysaj. Futbollisti i Napolit ka shprehur publikisht dëshirën për t'u larguar nga klubi italian dhe destinacionet nuk mungojnë. Pengesa e vetme që mban peng të ardhmen e futbollistit shkodran është kërkesa e Napolit. Bardhekaltrit kërkohet plot 25 milionë euro për futbollistin e kombëtares, ndërkohë që skuadra më e interesuar për anësin e djathtë, Atletico Madrid, është ndalur në 15 milionë. E ardhmja e 25-vjeçarit është në udhëkryq, shkruan "Abcnews".

Bomberi i kombëtares, Armando Sadiku, pritet t'i japë fund aventurës në Spanjë te Levante. Trajneri Paco Lopez nuk e ka aktivizuar sulmuesin në asnjë prej takimeve miqësore dhe i ka komunikuar se nuk bën pjesë në planet e tij për sezonin e ardhshëm. Sadiku ka oferta nga kampionati turk, por kërkon të qëndrojë në Spanjë.



Balliu, Ajeti, Grezda dhe Aliji janë në kërkim të një aventure të re dhe situata është mjaft e ndërlikuar. Mesfushori Ergys Kaçe është rikthyer te PAOK-u pas huazimit njëvjeçar te skuadra e Panathinaikosit, por e ardhmja mbetet e paqartë. Nuk dihet me siguri nëse shtatshkurtri do të shitet përfundimisht apo do të qëndrojë te PAOK-u që zotëron kartonin e futbollistit.

Qendërmbrojtësi i kombëtares, Kastriot Dermaku, u transferua në Serinë A te skuadra e Parmës. Një ngjitje e jashtëzakonshme në karrierën e futbollistit shqiptar, por nuk dihet ende nëse do të luajë sezonin e ardhshëm te

klubi italian apo do të huazohet diku tjetër për të luajtur me tepër pasi te Parma nuk e ka të sigurt vendin e titullarit. Sokol Cikallesi mund të largohet nga Turqia ku aktivizohet prej katër sezonesh. Aventura në futbollin turk është shoqëruar me ulje-ngritje për sulmuesin e kombëtares. Kristal Abazaj, një ndër emrat më të lakuar në Shqipëri, i cili konsiderohej si e ardhmja e sulmit të kombëtares, mund të rikthehet tek Anderlecht në Belgjikë ose të vijojë edhe për një tjetër sezon tek Osijeku në futbollin kroat. Futbollisti shqiptar nuk përmbushi pritshmëritë tek Anderlecht dhe e ardhmja është në dyshim.

Wilder: Së shpejti përballna me Ortizin, kam një këshillë për Joshuan

Deontay Wilder ka dhënë një intervistë për "ESPN", ku ka folur për planet e së ardhmes së tij. Kampioni i botës u shpreh se fillimisht do të ndeshet me kubanezin Luis Ortiz, ndërsa më pas radhën e ka Tyson Fury, kundërshtar me të cilin synon ta sheshojë barazimin e dhjetorit të vitit të kaluar. "Po duelet me Luiz Ortiz dhe Tyson Fury po bëhen gati. Fillimisht do ta lajmëroj datën dhe vendin për duelin me Ortiz. S'besoj se do të vonojë shumë. Më pas do të punojmë për Tyson Fury, me të do të ndeshemi nga fillimi i vitit tjetër. Jam një boksier që tenton të luftojë gjithmonë më të mirët, kështu u jap fansave duele interesante për t'u parë. Këtë gjë bëjnë kampionët", ka thënë Wilderi.



një këshillë për Anthony Joshuan. "Humbja ndaj Ruiz ishte shumë e dhunshme. Po të isha në vendin e tij s'do të ndeshesha përsëri me Ruizin. Këshilla ime për të është që të bëjë atë që mendon se është e

drejtë. Do të ishte mirë të bënte një ndeshje nxehjeje me një kundërshtar të një niveli më të dobët. Kjo gjë do ta ndihmonte në aspektin mendor, do të fitonte shumë vetëbesim", ka deklaruar Wilderi.

SHKURT

Ribery, afër Liverpoolit

Franck Ribery vazhdon të jetë lojtar i lirë që prej largimit nga Bayern Munchen. E përditshmja franceze "L'Equipe" zbulon se ashi francez mund të transferohet në Premierë Ligë. Trajneri Jurgen Klopp e dëshiron Riberyn si zëvendësues për treshen e sulmit Salah-Mane-Firmino. 36-vjeçari ende nuk ka marrë një vendim për të ardhmen, por e tundon mundësia që t'u bashkohet kampionëve të Evropës.

Ramirezi fiton titullin në WBO

Jose Ramirez e ka mposhtur Maurice Hooker për t'i unifikuar tituj në kategorinë e peshës super të lehtë në boks, në meçin që u zhvillua në College Park Center në Teksas. Ramirezi është tani mbajtës i titujve WBO dhe WBC pas fitores ndaj Hookerit të shtunën në Teksas. Gjyqtari e ndali meçin në rundin e gjashtë pas goditjeve të forta dhe njëpasnjëshme të Ramirezit ndaj Hookerit. Për boksierin nga Tekasi, kjo ishte humbja e parë në karrierë si profesionist. "Jam shumë i lumtur. Kjo më bën të kuptoj se jam në rrugë të duhur për t'u bërë luftëtar edhe më i mirë e, po ashtu, profesionist më i mirë. Jam i gatshëm për këdo", ka deklaruar Ramirezi.

Bakayokon nuk është në planet e Chelseat, kërkohet nga Evertoni

Tiemoue Bakayoko edicionin e kaluar është paraqitur mirë në fanelën e skuadrës së Milait, por drejtuesit e klubit kuqezi nuk u bindën që ta blinin kartonin e tij. Siç raporton "Daily Mail", trajneri i Chelseat, Frank Lampard, nuk e llogariti mesfushorin për sezonin që vjen dhe kështu ai pritet ta pranojë ofertën për të shkuar te ekipi i qytetit të Liverpoolit, Everton.

Nainggolani pranon largimin nga Interi

Mesfushori belg Radja Nainggolan ka pranuar të largohet nga Interi, pasi nuk bën pjesë në planet e trajnerit të ri, Antonio Conte. Mediumet italiane kanë raportuar se Nainggolan tashmë ka nisur negociatat me Cagliari për një kthim të mundshëm te ekipi ku luajti për katër vjet (2010-2014). Nainggolan ka kontratë me Interin deri në vitin 2022, por mund të largohet për një ofertë prej 20 milionë eurosh. Te Cagliari e shohin 31-vjeçarin si përforsim të duhur për repartin e mesfushës.

Zaniolo i qëndron besnik Romës

Nicolo Zaniolo do të vazhdojë të jetë pjesë e Romës dhe shumë shpejt do të firmosë me verdhekuqtë një kontratë të re deri në verën e 2024-s, ndërsa paga pritet t'i shkojë 1.9 milion euro, plus bonuset. I rikthyer vetëm pak ditë më parë nga pushimet, talenti italian është bindur nga trajneri Paolo Fonseca, që i ka garantuar atij një vend si titullar pas sulmuesit kryesor, ose si sulmues krahun, ndërsa drejtori sportiv Petrachi, përveç rinovimit, i ka premtuar edhe një rol prej lideri në skuadrën e re që po ndërtohet. Zaniolo kërkohet nga Juventusi e Tottenhami, të cilat ishin të gatshme të paguanin 45 milionë euro në arkat e Romës.

Galhanoglu: Dua të luaj pas sulmuesve

Milani është hedhur në kërkim të një fantazisti për ta vënë në dispozicion të trajnerit Giampaolo dhe lista e pretendentëve për atë rol është e gjatë, por së fundi është shtuar edhe një prej futbollistëve të organikës kuqezi. Bëhet fjalë për Hakan Calhanoglu, i cili në një intervistë për mediat italiane, ka theksuar se rolin e tij ideal, ka atë të numrit 10, pas sulmuesve dhe se është gati t'i udhëheqë kuqezinjtë drejt sukseseve. "Ndihem një numër 10 dhe besoj se është roli im ideal në fushën e lojës. Kam dy sezone në Itali dhe ndryshe nga Gjermania, këtu vrapohet më shumë, por besoj se jam ambientuar tashmë. Kam bindjen se ky do të jetë viti im", ka thënë futbollisti turk. Aktualisht Giampaolo po provon Suson në rolin e fantazistit, në pritje të brazilianit Paqueta dhe nëse asnjëri prej tyre nuk do të bindë, atëherë do të tentohet emra të tjerë si Correa apo De Paul.

NJË VIT PA BABËN DAN


RAMADAN KRYEZIU

Babë i dashur, sa hap dhe mbyll sytë një vit pa ty iku shpejt. Edhe pse po përpiqem që dhembjen ta bluaj brenda vetes, nganjëherë po e kam të pamundur. Kudo që shkoj më shfaqesh ti, e dëgjoj një fjalë tënden, e shoh një buzëqeshje të zbehtë që më afrohet ngadalë dhe më ikën shpejt.

Krenohem për burrërinë që kishe, për nderin që le pas, bashkë me shumë punë të mira ndër fqinjë, shokë dhe miqësi.

U prehsh në paqe, babë!

E kujton Sheremet Kryeziu me familje.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ "Tehnaservis" SH.P.K. shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811324805.
- ▶ Durguti Gold - V, shpall të pavlefshme certifikatën e regjistrimit të biznesit si dhe numrin e TVSh-së: 600636213.
- ▶ Beslind Elshani shpall te pavlefshme diplomën SHME "Ymer Prizreni" Prizren
- ▶ NOVONORDISK PHARMA OPERATIONS A/S, Kosovo Branch shpall të pavlefshme certifikatën e regjistrimit më numër: 600483408.
- ▶ Sefer Hysen Shyti me nr. personal 1004883213 shpallë të pavlefshme certifikatën e veteranit Invalid të UÇK-së, të lëshuar nga Komisioni Qeveritarë për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit invalidit veteranit pjesëtarit apo të internuarit të luftës së UÇK-së.
- ▶ Dekoral Aluminyum San Va Tic A.S- Kosovo Branch dega në Kosovë shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70882086 me nr fis. 600865680
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

KONKURS**EDUKIDS NË FERIZAJ, SHPALL KONKURS:**

- Edukatore - 3 vende të lira;
- Motër Edukatore - 3 vende të lira;
- Kuzhinierë - 1 vend i lirë;
- Pastruese - 1 vend i lirë.

Për të qenë pjesë e EduKids në Ferizaj, ju duhet t'i plotësoni këto kushte dhe kritere:

- Edukatore dhe motër edukatore
Të keni të kryer Fakultetin e Edukimit (Drejtimi Parashkollor, Pedagogji);
Të keni të kryer Shkollën e mesme të mjekësisë - Drejtimi i Përgjithshëm;
Drejtimi i Pediatrisë; Drejtimi Mamisë ose edhe Fakultetin e Mjekësisë - Drejtimi Infjermeri (vlen vetëm për motër edukatore);
Përvojë pune;
Të keni aftësi të shkëlqyera komunikative për të krijuar raporte ndërpersonale me fëmijët;
Të jeni persona të besueshëm, të përgjegjshëm, fleksibël, te motivuar, energjikë dhe emocionalisht të gatshëm për t'u përballuar me situata emergjente;
Të njihni mirë psikologjinë dhe botëkuptimin e fëmijeve;
Të jepni ndihmën e parë në rastet emergjente.

- **Kuzhinierë**

- Të keni të përfunduar shkollimin e mesëm si dhe përvojë pune së paku 2 vite;
Të keni aftësi të shkëlqyera komunikative për të krijuar raporte ndërpersonale me stafin dhe fëmijët;
Të jeni persona të besueshëm, të përgjegjshëm, fleksibël, te motivuar dhe energjikë.

- **Pastruese**

- Të keni të përfunduar shkollimin e mesëm si dhe përvojë pune së paku 2 vite;
Të jeni persona të besueshëm, të përgjegjshëm, fleksibël, te motivuar dhe energjikë.

Kandidatet e interesuara duhet të kompletojnë dokumentet:

- CV;
- Diploma dhe çertifikatat e trajnimeve (nëse keni);
- Dëshmitë mbi punët paraprake (nëse keni punuar më herët);
- Çertifikata e lindjes.

Të gjitha këto dokumente duhet të dërgohen në adresën: edukids05@gmail.com
Për info shtesë, kontaktoni EduKids +383 45 714 713 (viber&whatsApp)
KONKURSI MBETET I HAPUR DERI MË 31 KORRIK 2019

Vetëm kandidatet e kualifikuara do të ftohen për intervistë

**KONKURS**

- Edukatore** - 3 vende të lira
- Motër Edukatore** - 3 vende të lira
- Kuzhinierë** - 1 vend i lirë
- Pastruese** - 1 vend i lirë

CV-të e kompletuara me dokumentet e kërkuara
të dërgohen në: edukids05@gmail.com deri në datën **31 Korrik 2019**

Për info shtesë, kontaktoni: **+383 45 714 713**

